

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5547
E enjte, 9 gusht 2018
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Lidhjet dhe dashuria e ndërsjellë shqiptare do të forcohen edhe më shumë **FAQE 2**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

ARRESTOHEN 16 PERSONA PËR KONTRABANDË, EDHE SHTATË TË TJERË JANË NË KËRKIM **F. 6**

ISH-MINISTRJA TAHIRI: QEVERIA KA DËSHTUAR NË DIALOGUN ME SERBINË **F. 3**

NGJARJE TRAGJIKE NË GJAKOVË, 43-VJEÇARI VRET GRUAN DHE VAJZËN **F. 10**

EKONOMI

SIGUROHEN 3.8 MILIONË EURO PËR SEKTORIN E BUJQËSISË **F. 8-9**

LEKAJ: AUTOSTRADA 'ARBËN XHAFERI' DO TË PËRFUNDOJË MË 31 DHJETOR TË KËTIJ VITI **F. 9**



SPORT

VESELI: NË VITIN 2019 FILLON NDËRTIMI I STADIUMIT KOMBËTAR

PRISHTINA, MUNGESA NË FINALEN E SUPERKUPËS **F. 18**



FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURATI **FAQE 4-5**

Ridefinimi i kufijve, zgjidhja më e drejtë

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka vlerësuar se zgjidhja më e mirë e problemit në mes të Kosovës dhe Serbisë është ridefinimi i kufijve bazuar në vullnetin e popujve. Ai ka thënë se ky variant do ta mbyllte konfliktin, do ta hapte rrugën për pajtimin e popujve si dhe do t'i krijonte parakushtet që Kosova të bëhet shtet funksional. Në këtë inter-

vistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka deklaruar se partitë politike duhet të ndërtojnë një platformë të bisedimeve me Serbinë dhe në qendër të tyre ta vendosin reciprocitetin, që nënkupton se të njëjtat të drejta që gëzojnë serbët në tri komunat veriore, po ato t'u garantojnë edhe shqiptarëve në Kosovën Lindore. Ai ka folur edhe për qeverisjen në vend, për të cilën ka thënë se më shumë ka karakter anarkik sesa të një qeverisjeje normale

Thaçi: Bashkimi i Luginës me Kosovën do të jetë temë e dialogut në Bruksel



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë për media ka bërë me dije të mërkurën se kërkesën e tri komunave, Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, për bashkim me Kosovën, do ta paraqesë në bisedimet me Serbinë në Bruksel. Ai ka përsëritur se nuk do të ketë ndarje të Kosovës, nuk do të ketë shkëmbim të territorit dhe nuk do të ketë as autonomi për serbët **FAQE 3**



KOLEGJI ISPE U ËSHTË KUNDËR-PËRGJIGJUR AKUZAVE TË MASHT-IT PËR PRESION NË PROCESIN E AKREDITIMIT

Mazrreku mohon akuzat për shantazh në procesin e akreditimit

Drejtori i Kolegjit ISPE, Avni Mazrreku, ka mohuar akuzat se në procesin e vendimmarrjes për akreditim i ka bërë presion Agjencisë së Akreditimit. Ai ka akuzuar këtë agjenci dhe ministrin e Arsimit, Shyqiri Bytyqi, se qëllimisht dhe kundërligjësisht nuk ia kanë akredituar programet e kërkuara nga ISPE-ja. Për këtë ai ka paralajmëruar edhe kallëzim penal në prokurori. Ndërkaq ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka pohuar se ka pasur në vazhdimësi presione nga Kolegji ISPE që në mënyrë të padrejtë të akreditohen programet e këtij institucioni të arsimit të lartë privat **FAQE 7**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

NATO-ja tregon qëllimin e bazës ajrore në Shqipëri

Zëdhënësi Piers Cazalet tha se Programi i Investimit të Sigurisë së NATO-s mbulon projekte kryesore ndërtuese në vendet aleate me qëllim përmirësimin e sigurisë në hapësirën e NATO-s. "Ky program është pjesë e financimit të përbashkët të NATO-s në të cilin kontribuojnë të 29 vendet anëtare", tha zyrtari i NATO-s



TIRANË, 7 GUSHT - Zëdhënësi i NATO-s, Piers Cazalet, thotë se financimi i bazës ajrore në Kuçovë është pjesë e Programit të Investimit të Sigurisë. Investimi, sipas tij, kap vlerën e 51 milionë eurove. "NATO ka në plan të investojë 51 milionë euro për ta modernizuar bazën ajrore të Kuçovës në Shqipëri. Paratë do të shkojnë drejt përmirësimit

të infrastrukturës në bazë, përfshirë edhe depot e karburantit", konfirmoi Cazalet. Duke folur për ATSH, ai thotë se Programi i Investimit të Sigurisë së NATO-s mbulon projekte kryesore ndërtuese në vendet aleate me qëllim përmirësimin e sigurisë në hapësirën e NATO-s. "Ky program është pjesë e financimit të përbashkët të NATO-s në të



cilin kontribuojnë të 29 vendet anëtare", tha zyrtari i NATO-s. Aleanca, thotë Cazalet, i është mirënjohëse Shqipërisë për kontributin në NATO. "Ne jemi mirënjohës për kontributin e çmuar të Shqipërisë për sigurinë tonë të përbashkët, përfshirë misionet tona në Afganistan dhe Kosovë. Shqipëria gjithashtu u jep një mbështetje të fortë partnerëve tanë, përfshirë kontributin në fondet tona të kujdestarisë për Ukrainën, ndihmën në mbrojtjen kibernetike dhe transicionin e karrierës ushtarake", deklaroi ai. Shqipëria, theksoi Cazalet, luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në luftën kundër ISIS-it, duke kontribuar me pajisje dhe trajnime për Irakun. "Shqipëria gjithashtu na ndihmon të rrisim sigurinë

duke promovuar bashkëpunimin në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Vendi juaj është një avokat i fortë i politikës së dymë hapura të NATO-s dhe i integritetit të fqinjëve tuaj në familjen euro-atlantike", tha zëdhënësi i NATO-s, Piers Cazalet. Përmes këtij projekti, i cili pritet të nisë brenda këtij viti, Kuçova do të shërbejë si bazë mbështetëse për NATO-n për furnizim ajror; mbështetje logjistike; mbështetje për policimin ajror; si dhe trajnime dhe stërvitje të Aleancës. Kuçova do të shërbejë gjithashtu edhe si bazë kombëtare për Forcën Ajrore shqiptare dhe investimi i NATO-s në Shqipëri do të sjellë një standard të ri për Forcat e Armatosura dhe investime për zonën e Kuçovës.

Investimet e NATO-s në Shqipëri, mbështetje edhe për Kosovën

LONDËR, 8 GUSHT - NATO-ja po rrit influencën në Ballkanin Perëndimor, ndërkohë që përgatitet ta ngrehë bazën e parë ajrore në rajon si dhe u ka kërkuar vendeve të Ballkanit t'i bashkohen zyrtarisht aleancës, ka shkruar të mërkurën gazeta prestigjioze britanike "Express". Më 4 gusht kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, njoftoi se NATO-ja synon ta ndërtojë bazën e vet të parë të Ballkanit Perëndimor në qytetin e Kuçovës, ndërkohë që punimet

do të fillojnë këtë vit. Kryeministri theksoi se "zyrtarët janë duke diskutuar me ShBA-në për t'i modernizuar kapacitetet ajrore të Shqipërisë". Shqipëria u bë pjesë e NATO-s që në vitin 2009 dhe është ende duke zëvendësuar arsenalin e vjetruar të armatimeve. Ky vend ka dalje në detin Adriatik dhe Jon, si dhe ndodhet në veriperëndim të Greqisë.

Kryeministri Rama njoftoi nëpërmjet profilit të vet në

"Facebook" se Këshilli i Atlantikut të Veriut i NATO-s do të investojë 50 milionë euro. Kjo bazë do të përdoret për furnizime ajrore, mbështetje logjistike, patrullim ajror dhe trajnime.

Baza do të përdoret edhe nga forcat ajrore shqiptare. Zëvendëssekretari i përgjithshëm i NATO-s, Rose Gottemoeller, tha se Aleanca do t'i mbështesë reformat në Kosovë, përfshirë krijimin e forcave të saj të armatosura të rregullta.



Presidenti Hashim Thaçi ka mbajtur sërish konferencë për medie rreth idesë së korigjimit të kufirit me Serbinë në kuadër të dialogut që po zhvillohet në Bruksel

Qeveria kërkon më shumë punë për zbatimin e MSA-së



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë për media ka bërë me dije të mërkurën se kërkesën e tri komunave, Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, për bashkim me Kosovën, do ta paraqesë në bisedimet me Serbinë në Bruksel. Ai ka përsëritur se nuk do të ketë ndarje të Kosovës, nuk do të ketë shkëmbim të territorit dhe nuk do të ketë as autonomi për serbët

dhe Bujanocit me Republikën e Kosovës. "Korigjimi i kufijve nënkupton bashkëngjitjen e plotë, në tërësi të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit në Republikën e Kosovës që duhet të jetë një proces i rregullt dhe transparent e paqësor në mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka theksuar se kërkesa e përfaqësuesve të Luginës së Preshevës që t'i bashkohen Kosovës do të shtrohet si temë në Bruksel. "Unë do ta prezantoj në Bruksel këtë kërkesë. Kjo do të jetë e vështirë, pothuajse e pamundur. Nëse nuk do të arrijmë, do të kthehemi në pozicionet ku kemi qenë", ka thënë ai.

Në një konferencë me gazetarë, Thaçi ka deklaruar se faza finale e dialogut me Serbinë, që ndërmyjetësohet nga Bashkimi Evropian, është e vështirë por, sipas tij, e

domosdoshme. Sipas Thaçit, mundësia për të arritur një marrëveshje finale me Serbinë është minimale. Ai ka thënë se, megjithatë, në këtë drejtim po bëhen përpjekje "maksimale që të shfrytëzohet çdo mundësi që të kemi një marrëveshje historike përmes dialogut". Ai ka thënë se vetëm duke arritur marrëveshje me Serbinë si fqinjë, Kosova sigurohet se do të mund ta zë perspektivën euroatlantike. "Unë kam bërë të qartë se mundësitë për të arritur një marrëveshje me Serbinë janë jashtëzakonisht të vogla, por duhet të bëjmë përpjekje maksimale që në fund të arrijmë një marrëveshje historike të udhëhequr nga BE-ja dhe me mbështetje nga ShBA-ja. Dialogu ka një qëllim thelbësor, arritjen e marrëveshjes për normalizim, njohjen reciproke dhe pajtimin", ka thënë presidenti Thaçi.

Sa iu takon marrëveshjeve të

arritura në procesin e dialogut politik, presidenti Thaçi tha se të gjitha marrëveshjet do të zbatohen, duke përfshirë edhe atë të themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Thaçi theksoi se Asociacioni do të themelohet duke respektuar marrëveshjen e Brukselit, Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Thaçi, pos të tjerash, tha se askush nuk do të vijë as në Kosovë e as në Serbi që t'i rregullojë punët dhe se sa më parë që të ndodhë pajtimi, aq më parë do të ketë integrim në Bashkimin Evropian. "Prandaj, duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm karshi interesave të qytetarëve, duke respektuar të kaluar e hidhur që kemi mes vete, duke mos e harruar, por le të ndodhë pajtimi dhe le të ndodhë mirëkuptimi, fqinjësia dhe e ardhmja evropiane e sigurt", ka thënë presidenti Thaçi.

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 GUSHT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, sërish ka folur të mërkurën për mundësinë e korigjimit të kufirit me Serbinë, siç ka thënë ai, në mënyrë "paqësore", ku me këtë rast ka ripërsëritur qëndrimin e tij që komunat jugore të Serbisë, Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të hyjnë në kuadër të territorit të Kosovës. Ai ka përsëritur se nuk do të ketë ndarje të Kosovës, nuk do të ketë

shkëmbim të territorit dhe nuk do të ketë as autonomi. "Kjo nënkupton jo ndarje të Kosovës, jo shkëmbim territori, jo autonomi për serbët, por korigjim të kufirit dhe njohje e anëtarësim të Kosovës në të gjitha mekanizmat ndërkombëtarë. Synimi im nuk është ndryshim i kufijve, është korigjim i tyre. Kemi diku 400 kilometra kufi që duhet të ndodhë si demarkim mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Thaçi. Ai ka thënë se korigjimi i kufijve nënkupton bashkëngjitje të plotë të Preshevës, Medvegjës

Ish-ministrja Tahiri: Qeveria ka dështuar në dialogun me Serbinë



PRISHTINË, 8 GUSHT - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka vlerësuar se Qeveria e Kosovës ka dështuar në këtë dialog, duke mos marrë primatin e udhëheqjes së këtij procesi. "Unë mendoj se kjo Qeveri ka dështuar në dialog, fare nuk është marrë me këtë temë. Vetë kryeministri ka thënë se unë

nuk merrem me dialogun e Brukselit. Një kryenegociator vetëm nuk mund të bëjë asgjë pa mbështetjen e Qeverisë dhe kryeministrit. Është emëruar Avni Arifi i cili asgjë nuk ka bërë, sepse ka munguar mbështetja e Qeverisë dhe kryeministrit", ka deklaruar Tahiri në një intervistë dhënë për "Telegrafin". Sipas Tahirit, Serbia do të vazhdojë të

paraqesë skenarë të ndarjes së Kosovës. Madje, sipas saj, Serbia po synon ta realizojë idenë e Serbisë së Madhe, duke e përfshirë copëtimin e territorit të Kosovës. Tahiri ka thënë se është paksa e befashuar me heshtjen e Bashkimit Evropian (BE) gjatë këtyre ditëve që po diskutohet për temën e shkëmbimit të territoreve.

Flet për "Epokën e re", Valon Murati

Ridefinimi i kufijve,

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka vlerësuar se zgjidhja më e mirë e problemit në mes të Kosovës dhe Serbisë është ridefinimi i kufijve bazuar në vullnetin e popujve. Ai ka thënë se ky variant do ta mbyllte konfliktin, do ta hapte rrugën për pajtimin e popujve si dhe do t'i krijonte parakushtet që Kosova të bëhet shtet funksional. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka deklaruar se partitë politike duhet të ndërtojnë një platformë të bisedimeve me Serbinë dhe në qendër të tyre ta vendosin reciprocitetin, që nënkupton se të njëjtat të drejta që gëzojnë serbët në tri komunat veriore, po ato t'u garantohen edhe shqiptarëve në Kosovën Lindore. Ai ka folur edhe për qeverisjen në vend, për të cilën ka thënë se më shumë ka karakter anarkik sesa të një qeverisjeje normale



Krejt kjo nuk jep shpresë për një proces nga i cili në fund do të kemi një zgjidhje të qëndrueshme dhe të drejtë të raporteve shqiptaro-serbe, përkatësisht të problemeve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

"Epoka e re": Tashmë është lansuar edhe ideja që në kuadër të dialogut të diskutohet edhe për zgjidhjen e çështjes së Luginës së Preshevës si dhe të ketë korrigjim të kufirit me Serbinë. Lëvizja për Bashkim është për një korrigjim të tillë?

Murati: Lëvizja për Bashkim që prej vitit 2010 ka dalë publikisht me platformën për zgjidhjen e çështjes shqiptaro-serbe. Kjo platformë përmban katër shtylla kryesore: 1. Bisedimet duhet të

zhvillohen në mes të dy shteteve; 2. Pavarësia e Kosovës është e panegociueshme; 3. Bisedimet duhet të zhvillohen për çështjet e pazgjidhura në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe zgjidhjet duhet të bëhen mbi bazën e reciprocitetit: të gjitha të drejtat që do të mund t'i përfitojnë tri komunat veriore të Kosovës - Leposaviq, Zveçan e Zubin Potok duhet t'i gëzojnë edhe tri komunat e Kosovës Lindore - Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, dhe kjo duhet të shkojë deri në ridefinimin e kufirit në bazë të vullnetit të banorëve të këtyre zonave; dhe 4. Pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës dhe fshatrat shqiptare përreth saj nuk mund

të jenë temë e bisedimeve. Atje është kryer spastrim etnik ndaj shqiptarëve dhe ata duhet të kthehen në pronat e veta. Pra, prej vitit 2010 e deri më tani ne kemi ngulmuar se qasja ndaj bisedimeve me Serbinë duhet të ndryshojë në mënyrë që në tryezën e bisedimeve ne t'i vendosim problemet kryesore që mendojnë të dy shtetet dhe të dy popujt dhe në to të mos flitet vetëm për Kosovën dhe për serbët. Ngulmimi ynë disaveçar ka qenë që ne, pra, partitë politike në vend, duhet të ndërtojmë një platformë të bisedimeve me Serbinë dhe në qendër të tyre ta vendosim reciprocitetin. Kjo ka nënkuptuar që të njëjtat të drejta që (do t'i) gëzojnë serbët në tri komunat veriore, t'u garantohen

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 GUSHT -

"Epoka e re": Z. Murati, si e vlerësoni qeverisjen e deritanishme nga koalicioni PAN dhe rolin opozitar të LDK-së, LV-së dhe PSD-së?

Murati: Të them të drejtën, vështirë është të thuhet edhe se ka qeverisje në Kosovë. Kemi një sërë vendimesh që më shumë i japin kësaj qeverie karakter anarkik sesa të një qeverisjeje normale. Ka raste kur duket se qeveria nuk e di fare se çfarë po ndodh, siç ishte rasti i arrestimit të Gjuriqit, rasti i arrestimit të gjashtë shtetasve turq, apo edhe tani rreth bisedimeve me Serbinë. Kemi një situatë jashtëzakonisht absurde ku, për shkak të numrave dhe mënyrës se si është krijuar qeveria, ajo vështirë se funksionon për shkak të dinamikave në mes të partnerëve të koalicionit. Sigurisht ka sektorë, sikur në atë të shëndetësisë, ku duket se ka një përpjekje serioze nga ana e ministrit për ta ndryshuar për të mirë. Por këto përpjekje deri më tani janë të copëzuara dhe nuk vërehet se ka një qasje të koordinuar të Qeverisë në të gjithë sektorët për ta përmirësuar situatën. Për më tepër, situata është keqësuar sa i përket nepotizmit dhe klientelizmit partiak në punësimet në institucionet shtetërore dhe në ndërmarrjet publike. Absurdi tjetër zhvillohet në kampin opozitar. Ndonëse me numra, opozita është ndër më të fortat. Sa iu përket veprimeve dhe fuqisë ndikuese në qeverisjen e vendit, kjo opozitë është ndër më të dobëtat. Andaj e kam theksuar disa herë se jetëgjatësia e kësaj Qeverie do të jetë përtej asaj që mendohej fillimisht.

"Epoka e re": Gjatë kësaj periudhe vendi është ballafaquar me probleme dhe sfida të ndryshme. Një prej tyre është dialogu me Serbinë. Si e shihni përfundimin e këtij procesi dhe a po përgatiten si duhet institucionet për këtë çështje?

Murati: Fatkeqësisht, që prej fillimit të dialogut me Serbinë, në vitin 2011, Kosova ballafaqohet me të njëjtin problem: pala e Kosovës nuk ka një platformë të bisedimeve. Deri më tani agjenda e bisedimeve është përcaktuar nga të tjerët dhe në vazhdimësi është folur vetëm për Kosovën dhe për të drejtat e pakicës serbe. Kjo situatë po vazhdon e njëjtë edhe sot. Tani kur po trumbetohet se po futemi në fazën finale të bisedimeve, institucionet e vendit jo vetëm se nuk kanë një platformë politike konsensuale por, për më keq, kemi një ngarendje të forcave politike që qasjen ndaj bisedimeve ta ndërtojnë duke e parë nga prizmi i rezultateve të mundshme elektorale. Kjo e vështirëson situatën dhe, siç u pa, kjo u dëshmuar edhe përmes tryezave të partive politike, të cilat, për shkak të mungesës së vullnetit politik, dështuan në ndërtimin e një konsensusi dhe platforme politike të bisedimeve. E njëjta atmosferë mbretëron në Kuvendin e Kosovës. Atmosfera e një beteje politike të pakompromis e ka sjellë këtë institucion buzë mosfunksionalitetit të plotë. Në vend se të kemi një debat për një platformë politike dhe se çka duhet të përmbajë ajo, partitë politike tash e disa muaj merren se kush do t'i udhëheqë bisedimet. Gjithashtu, tani vërehen papajtueshmëri të thella sa iu përket bisedimeve edhe brenda vetë kampit qeveritar, si dhe në relacionin qeveri-presidencë.

zgjdhja më e drejtë



edhe shqiptarëve në Kosovën Lindore. Më vonë e kemi zgjeruar këtë koncept, duke ofruar alternativën që nëse nuk shkon varianti i parë, të kërkohet reciprociteti në të drejta për të gjithë shqiptarët në Serbi, kudo që ata jetojnë, me ato të serbëve në Kosovë, që do të shkonte deri te vendet e garantuara për shqiptarët në parlamentin serb dhe e drejta e vetos ashtu si e kanë serbët dhe pakicat e tjera në Kosovë. Ridefinimi i kufijve, bazuar në vullnetin e popujve për vetëvendosje, do të vinte si përfundim i këtij procesi apo pas një relaksimi të marrëdhënieve në mes të dy shteteve dhe popujve dhe zbatimit të parimit të reciprocitetit në ndërkohë. Nuk ka dyshim se duke e ditur edhe

qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare për mosndryshim të kufijve, kemi ngulmuar fillimisht për reciprocitetin në të drejta që nuk do të prekte kufijtë. Sidoqoftë, e kemi theksuar hapur se varianti më i mirë është varianti i ridefinimit të kufijve bazuar në vullnetin e popujve, sepse ky variant jo vetëm se do ta mbyllte konfliktin e do ta hapte rrugën për pajtimin e popujve tanë, por edhe do t'i krijonte parakushtet për ndryshime kushtetuese në Kosovë dhe shndërrimin e saj në një shtet funksional.

"Epoka e re": Mund të përcillet me pasojë ky proces?

Murati: Zgjdhja më e mirë që do ta shtronte rrugën për paqe e

pajtim, e që është reciprociteti në të drejta deri në ridefinim të kufijve, po paraqitet si gogol në opinionin publik. Përderisa zgjidhja që mund të rrjedhë si pasojë e kësaj zhurme, asociacioni, apo madje edhe ndonjë formë më e avancuar e autonomisë territoriale për serbët, e që mund të paraqitet si fitore në një moment (kinse e ruajtëm integritetin territorial), është zgjidhja më fatale për Kosovën. Kjo zgjidhje, në një situatë të mëvonshme, mund të përfundojë vërtet me ndarje të Kosovës, me vendosjen e kufirit aty ku e ka synim Serbia: përgjatë lumit Ibër. Por pse është më e komplikuar të shpjegohet se ky variant i fundit është më i rëndë për Kosovën dhe

shqiptarët? Sepse jofunksionaliteti i shtetit nuk ndihet si një goditje fatale, por si një sërë goditjesh të vogla, por të vazhdueshme dhe konsistente, që do t'i jepen funksionalitetit të shtetit të Kosovës nga Asociacioni, i kombinuar me privilegjet juridike dhe politike që pakica serbe i ka me Kushtetutë. Krizat që do të prodhohen herë pas here nga ky rregullim politiko-juridik do të bëjnë që Kosova të mos mundet asnjëherë të merret me problemet e saj të jetës së përditshme, si: ekonomia, arsimit, shëndetësia, lufta kundër korrupsionit, çështjet sociale etj. Duke qenë se këto e zgjasin agoninë e shtetit të Kosovës, por e mbajnë atë gjallë me infuzion, krijojnë përshtypjen se ka një grimcë shprese që do të përmirësohet situata. Lufta partiake ndërshtetë do të acarohet, duke e rënduar edhe më tej situatën dhe duke pamundësuar propozime të guximshme dhe vizionare për dalje nga kriza. Në anën tjetër, sa i përket vazhdimin të konfliktit shqiptaro-serb, ai do të vazhdojë brenda Kosovës, i nxitur nga Serbia, por asnjëherë publikisht. Madje, Serbia do të paraqitet herë pas here edhe si faktor stabiliteti duke ndërmjetësuar për t'i 'qetësuar' gjakrat në mes të organeve qendrore të Kosovës dhe atyre të autonomisë serbe në Kosovë. Të gjitha këto, ajo në të vërtetë do t'i menaxhojë për ta arritur qëllimin final të saj, ndarjen e Kosovës, në një moment të përshtatshëm, tek kufiri në Ibër. Aq do të humbim terren në Kosovën Lindore, e rrjedhimisht edhe popullsi, sa në të tilla rrethana, vështirë se do të mund të kishte ridefinim të kufijve. Atëherë mund të na ndodhë vërtet ndarja e Kosovës.

"Epoka e re": Ideja e presidentit Thaçi që në kuadër të dialogut të përfaqësohet Lugina e Preshevës po përcillet me një frikë se pas kësaj mund të fshihet ndarja e Kosovës apo një lloj autonomie për veriun. Janë të mundshme këto opsione?

Murati: Sigurisht se është një hap i rëndësishëm para i presidentit Thaçi (deri tash vetëm deklarativ), që për herë të parë ka filluar ta shtrojë publikisht se në bisedimet me Serbinë do të flitet edhe për Preshevën, Bujanocin e Medvegjen. Deri më tani kjo çështje, siç e theksova, është injoruar tërësisht. Presidenti disa herë e theksoi se do të kërkojë që kjo pjesë t'i bashkohet Kosovës. Unë nuk e

di se sa i ka të njëmendta presidenti këto qëndrime dhe sa ka pajtueshmëri me faktorët e rëndësishëm të arenës ndërkombëtare (ndonjëse vërehet një ndryshim diskursi i një pjese të përfaqësuesve të këtyre të fundit), por besoj se edhe në këtë rast janë bërë disa gabime në hapa. Tërë energjia është dashur të përqendrohet në hartimin e një platforme konsensuale, ku do të përfshiheshin edhe përfaqësuesit politikë të Kosovës Lindore dhe të vendosesh reciprociteti në të drejta si parim i bisedimeve. Unë jam i sigurt se një qasje e tillë do të krijonte një unitet më të madh në skenën politike dhe nuk do të kishim reagime të shfrenuara kundër ridefinimit të kufijve siç po ndodhin tani. Për më tepër, reciprociteti në proces do të dërgonte domosdo në ridefinim të kufijve duke u bazuar në vullnetin e popujve, sepse ajo është zgjidhja më e drejtë. Përndryshe, terminologjia e përdorur këto ditë si ndarje, korrigjim i kufijve etj., e ka pasur edhe defektin se ka trajtuar vetëm territorin dhe pasuritë natyrore, por jo edhe njerëzit, të cilët në të vërtetë janë pasuria më e madhe për çdo shoqëri. Shumë më e drejtë do të ishte që në fokus të reciprocitetit dhe të ridefinimit të jetë vullneti i qytetarëve sesa territoret. Ky model, pra kur qytetarët vendosin për fatin e vet, është siguria më e fuqishme për zgjidhje të qëndrueshme. Përndryshe, alternativat e kësaj situatë do të jenë shumë të dëmshme për Kosovën. Ato janë asociacioni ose autonomia, që do ta bëjnë tërësisht jofunksional shtetin e Kosovës, dhe tjetra është vazhdimi i kësaj status quoje. Në të dy variantet, pas një kohe (qoftë edhe dekada) në rrethana të tjera, rreziku është i madh që Kosova të ndahet dhe që kufiri të na vendoset aty ku e ka synim Serbia, pra në lumin Ibër. E, në anën tjetër, Kosova Lindore mund të mbetet pa shqiptarë për shkak të shpërnguljeve të vazhdueshme. Andaj, çdo ditë e më shumë po vazhdoj të habitem se si ka njerëz në këtë shoqëri të cilët e trajtojnë me indiferencë totale mundësinë që Presheva, Bujanoci e Medvegja, me popullsinë e tyre shqiptare, kontribuuese të vazhdueshme në luftën për liri, të jenë pjesë e Kosovës, duke mbrojtur idenë e integritetit territorial dhe mbetjes në Kosovë të komunave me shumicë serbe, të cilat janë jo vetëm jolojale, por edhe e bëjnë në vazhdimësi shtetin e Kosovës jofunksional.

Miradije Kelmendi emërohet kryeinspektore e Policisë së Kosovës

Prishtinë, 8 gusht (ER) - Inspektorati Policor i Kosovës ka njoftuar se ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka emëruar Miradije Kelmendin kryeshefe ekzekutive të

Inspektoratit Policor të Kosovës. IPK-ja ka njoftuar se emërimi i Kelmendit ka ardhur pas përfundimit të procedurave të konkurrimit nga konkursi i shpallur më 4 korrik. "Ky vendim ka hyrë në

fuqi në ditën e nënshkrimit dhe nga data 2 gusht, Miradije Kelmendi do t'i kryejë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës", thuhet

në njoftimin e IPK-së. Emërimi i kryeshefit të ri në IPK ka ardhur pas shkarkimit të ish-kryeshefit Hilmi Mehmeti, i cili ka qenë i suspenduar nga detyra pas një hetimi.



Arrestohen 16 persona për kontrabandë, edhe shtatë të tjerë janë në kërkim

Prokuroria Speciale, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Doganën, të mërkurën në mëngjes në tri qytete të ndryshme kanë realizuar aksionin e quajtur "Rrjeta". Nga ky aksion janë arrestuar 16 persona, ndërsa edhe shtatë të tjerë janë në kërkim. Ata dyshohen për kontrabandim të mallrave të ndryshme



Z., R. B., A. A., A. D dhe J. M për shkak të dyshimit të arsyeshëm se kanë kryer vepra penale, me ç'rast gjatë periudhës hetimore nga korriku i vitit të kaluar janë ndërmarrë 11 veprime operationale, me qëllim të mbledhjes së dëshmive për krimin e organizuar dhe kontrabandimin e produkteve të ndryshme nga ana e tyre.

Nga dokumentacioni i siguruar

del se gjatë aktivitetit të tyre të pandehurit kanë kryer veprat e lartpërmendura në mënyrë të organizuar dhe të strukturuar, duke kontrabanduar: cigare pa banderola dhe me banderola të Maqedonisë, duhan të grirë, tekstil, vajra motorike dhe prodhime farmaceutike. Me këtë rast, përfaqësuesi i Policisë së Kosovës ka njoftuar në takim se, përveç 16 personave të arrestuar, në kërkim

janë edhe shtatë persona të dyshuar, kurse përfaqësuesi i doganave të Kosovës ka pohuar se totali i mallrave të kontrabanduara arrin vlerën e një milion eurove, kurse shumica e shmangieve të detyrimeve importuese arrin vlerën e përafërt prej 350 mijë eurove, ndërkaq vetëm gjatë operacionit të së mërkurës vlera e shmangieve nga detyrimet importuese arrin 100 mijë euro.

EPOKA
ERE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 8 GUSHT - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në kuadër të angazhimit të shtuar për luftimin e krimit të organizuar, në bashkëpunim me Doganën dhe Policinë e Kosovës, ka arritur që pas një hetimi njëvjeçar të arrestojë një grup të krimit të organizuar, i cili ka vepruar kryesisht përgjatë vijës kufitare Kosovë - Maqedoni dhe në rrethinën e Ferizajt.

Prokurori i Shtetit në Prokurorinë Speciale, Sylë Hoxha, ka bërë me dije se ky rast kishte filluar të hetohet nga viti 2017, duke paralajmëruar se

ndaj këtij grupi kriminal të arrestuar do të bëhet kërkesa për paraburgim dhe për vazhdimin e hetimeve të mëtejme për: veprat penale të organizimit të grupit kriminal nga neni 283, veprën penale të kontrabandimit të mallrave nga neni 317, shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318, paragrafi 3 dhe për shmangie nga tatimi - neni 313, paragrafi 3 i KRPK-së.

Hoxha ka konfirmuar se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka marrë aktvendim për fillimin e hetimit kundër të pandehurve F. I. Z. M., XH. I., A. B., M. B., N. S., B. S., H. S. I. J., U. J., K. Rr., J. J., D. B., A. I., H. A., G.

Policia konfiskon gjashtë armë në tri raste të ndara



PRISHTINË, 8 GUSHT - Njësitë Policore të Drejtorisë Rajonale në Prishtinë në tri raste të ndara kanë konfiskuar gjashtë armë zjarri si dhe fishekë të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm. Sipas njoftimit të policisë, aksioni i parë është realizuar nga njësitë policore të stacionit të Lipjanit, i cili ka rezultuar me shoqërimin në stacion policor të një personi të dyshuar A. R., të cilit i është gjetur dhe konfiskuar një revole me gaz "Ecol Special 99". Konfiskimi i armës është bërë në fshatin Banullë të Lipjanit, ku në një

aheng familjar ka pasur të shtëna me armë.

Në rastin e dytë janë konfiskuar dy revole dhe sasi e substancave narkotike dhe rasti është iniciuar në Stacionin Policor Qendra në Prishtinë.

Rasti i tretë është kryer nga Stacioni Policor në Fushë-Kosovë, ku personi i dyshuar Sh. I është arrestuar për sulm dhe kanosje me armë.

Rasti është trajtuar në koordinim të ngushtë me prokurorin e shtetit i cili ka urdhëruar konfiskimin e tri armëve: një revole e tipit

Beretta, dy pushkë gjuetie (të dyja me leje) si dhe 17 fishekë. Po me urdhër të prokurorit të shtetit personi i dyshuar është dërguar në qendrën e mbajtjes për 48 orë.

Policia ka bërë me dije se vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 nga njësitë policore të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë janë konfiskuar 239 armë, 2 584 municione të llojit dhe kalibrat të ndryshëm dhe janë iniciuar 194 raste të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve.

FSK-ja dhuron gjak për herë të dytë brenda vitit

PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) të mërkurën ka filluar aksioni humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut, me moton "Një pikë gjak për shpëtimin e një jete". Dhurimi i gjakut nga pjesëtarët e FSK-së është bërë

për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës. Aksionit, si gjithëherë, i janë përgjigjur një numër i konsiderueshëm i dhuruesve të gjakut. Vetëm në dy orët e para numri i dhuruesve kishte arritur në 24, numër ky që rritej

bazuar në radhët e pjesëtarëve që prisnin për t'i kaluar procedurat normale të ofruara nga ekipet mjekësore. Aksioni për dhurimin vullnetar të gjakut në MFSK do të vazhdojë në të gjitha kazernat e Forcës së Sigurisë së Kosovës deri më 11 shtator.



Kolegji ISPE u është kundërpërgjigjur akuzave të MASHT-it për presion në procesin e akreditimit

Mazrreku mohon akuzat për shantazh në procesin e akreditimit



Drejtori i Kolegjit ISPE, Avni Mazrreku, ka mohuar akuzat se në procesin e vendimmarrjes për akreditim i ka bërë presion Agjencisë së Akreditimit. Ai ka akuzuar këtë agjenci dhe ministrin e Arsimit, Shyqiri Bytyqi, se qëllimisht dhe kundërligjshëm nuk ia kanë akredituar programet e kërkuara nga ISPE. Për këtë ai ka paralajmëruar edhe kallëzim penal në prokurori. Ndërkaq ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka pohuar se ka pasur në vazhdimësi presione nga Kolegji ISPE që në mënyrë të padrejtë të akreditohej programet e këtij institucioni të arsimit të lartë privat

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 8 GUSHT - Drejtori i Kolegjit ISPE, Avni Mazrreku, ka mohuar të mërkurën akuzat e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, dhe të Agjencisë për Akreditim, se ky kolegji ka bërë shantazh dhe presion në procesin e vendimmarrjes të Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Në një konferencë për medie, Mazrreku ka akuzuar ministrin Bytyqi dhe këtë agjenci për veprime të paligjshme në këtë proces, duke thënë se ky institucion privat i arsimit të lartë i ka plotësuar kushtet e kërkuara për akreditim. "Ne po flasim për fakte, ata për deklaratat. Nëse ka një fakt konkret z. ministër ose ndonjë nga anëtarët e bordit të agjencisë se ka pasur një kërcënim, shantazh apo ka diçka të shkruar që mund të interpretohet si i tillë, unë do të ballafaqohem në prokurori", ka thënë Mazrreku. Ai ka deklaruar se vetë agjencia

në materialin e saj tregon se ky kolegji i plotëson kushtet. "Megjithatë, numri i stafit akademik të mbetur sipas tyre prapë është i mjaftueshëm. Mirëpo, vendimi, për çudi, është kontradiktor", ka thënë Mazrreku.

Ai ka akuzuar ministrin e Arsimit dhe Agjencinë e Akreditimit se qëllimisht dhe në mënyrë të kundërligjshme nuk kanë akredituar programet e këtij kolegji. "Agjencia e Akreditimit nuk e ka zgjatur akreditimin për programet tona, mirëpo ka zgjatur akreditimin e programeve për të gjitha institucionet e tjera. Ndërsa neve na jep akreditim institucional pa pasur nevojë, sepse e kemi pasur akreditimin institucional. Ideja e Agjencisë së Akreditimit ka qenë që ISPE-në ta lë pa asnjë program të akredituar. Kjo është shkelja e parë. Shkelja e dytë është se Agjencia e Akreditimit e tërheq akreditimin për programet e Kolegjit ISPE", është shprehur Mazrreku. Më tej, ai ka treguar se

Departamenti Ligjor i MASHT-it ka konstatuar se vendimi i Agjencisë së Akreditimit është i kundërligjshëm. Po sipas tij, ky interpretim nuk është bërë asnjëherë publik. "Interpretimi i Zyrës Ligjore të MASHT-it është që vendimet e Agjencisë së Akreditimit janë të kundërligjshme. Dhe ministri i Arsimit, pavarësisht që e ka shkruar një letër për Agjencinë e Akreditimit, ai nuk i ka cekur faktet kritike juridike që i ka thënë Zyra Ligjore në lidhje me veprimin e kundërligjshëm të Agjencisë së Akreditimit", është shprehur ai.

Mazrreku ka deklaruar se dokumentet e prezantuar në konferencë janë vetëm 5 për qind e informacionit që ka ky institucion, duke shtuar se në ditët në vijim do të vazhdojë të prezantojë parregullsi të reja që e kanë përcjellë procesin e akreditimit. "Ky është material shumë fillestar, i cili paraqet më pak se 5 për qind të të gjitha informacioneve dhe fakteve që ne disponojmë për keqberje nga ana e ministrit të Arsimit, z. Shyqiri Bytyqi dhe vartësve të tij në këtë rast, anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Akreditimit", ka thënë ai, duke paralajmëruar se në ditët në vijim të gjitha këto fakte do t'i prezantojë në prokurori. "Ditët në vijmë do të ofrojmë materiale të tjera për prokurorin e shtetit dhe me këtë rast i bëj thirrje kryeprokurorit, z. Lumezi, të krijojë një task forcë të posaçme që të ndërmarrë hetime masive ndaj ministrit dhe Agjencisë për Akreditim", ka thënë drejtori i Kolegjit ISPE, Avni Mazrreku.

Bytyqi një ditë më parë akuzoi Kolegji ISPE për presion

Një ditë më parë, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka reaguar ndaj letrës publike të Kolegjit ISPE, e cila i është drejtuar kryeministrit dhe institucioneve, ku është thënë se ISPE-së i është bërë e padrejtë me mosakreditimin e programeve të tij. Në një konferencë për medie, ministri Bytyqi ka vlerësuar se kjo letër është e tipit të shantazhit, në mënyrë që të bëhet presion në institucionet shtetërore. "Nuk është i sotëm presioni që ky kolegji bën ndaj institucionit tonë. Ka pasur në vazhdimësi presione që në mënyrë të padrejtë të akreditohej programet, gjegjësisht të ndikohet në Këshillin Shtetëror të Cilësisë për akreditimin e programeve të këtij institucioni", ka thënë ministri Bytyqi, ndërsa ka shprehur vendosmërinë të respektohen institucionet e pavarura. Ai ka thënë se është bërë një punë e jashtëzakonshme që të krijohet një Agjenci e Akreditimit dhe një Këshill Shtetëror i Cilësisë i pavarur dhe i pandikuar nga askush. Ministri Bytyqi vlerësoi se është kërkuar vazhdimisht nga Këshilli i Cilësisë të respektohet ligji dhe procedurat dhe të jetë profesional në vendimmarrje, gjë që edhe ka

ndodhur me vendimet e marra deri më tani. "Vendimet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë janë vendime të pavarura nga ministri. Nuk mund të ndikojë ministri në vendimmarrjen e këtij Këshilli", ka bërë me dije Bytyqi, duke treguar se në letrën e ISPE-së bëhet fjalë për vendimet e Këshillit dhe i adresohen ministrit. "Ne i bëjmë thirrje çdo institucioni që pretendon se ka pasur lëshime nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, të orientohet tek organet kompetente, por në asnjë mënyrë nuk do të lejojmë askënd të bëjë presione dhe shantazhe dhe të kemi institucione joligjore që nuk i respektojnë ligjet dhe kriteret", është shprehur ministri Bytyqi.

Ministri i bëri thirrje Kolegjit ISPE të angazhohet për plotësimin e kushteve që parashihen me ligj dhe mos të bëjë presion as ndaj Ministrisë e as ndaj Këshillit. "Besoj se Këshilli nuk do të bjerë pre e këtyre manovrimeve për qëllime dhe përfitime personale", është shprehur Bytyqi, duke theksuar se Këshilli Shtetëror i Cilësisë do ta ketë përkrahjen e tij të pazezervë nëse punën do ta bëjë në mënyrë profesionale dhe bazuar në kërkesat dhe procedurat ligjore.

Arrihet marrëveshja për punësimin e 250 të rinjve në Kosovë




PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Astrit Panxha nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) ka nënshkruar grant marrëveshje me "USAID EMPOWER", sektori privat, në partneritet me SIDA, për implementimin e projektit "On the Job Training Program" (Programi për Trajnimin në Punë). Ky program ka për qëllim t'i mobilizojë kompanitë në sektorin privat që të angazhohen në mënyrë më aktive për trajnimin e të rinjve dhe aftësimin e tyre profesional. "USAID EMPOWER", sektori privat së bashku me KPK-në dhe partnerë të tjerë, janë duke zhvilluar këtë program i cili synon ngritjen e aftësive profesionale tek të rinjtë dhe rritjen e mundësisë së punësimit të tyre. "Komunat në të cilat do të fillojë të implementohet ky program janë komuna e Gjilanit, e

Vitisë, e Kaçanikut dhe e Hanit të Elezit. Përfituesit e këtij projekti do të jenë 250 kandidatë nga këto komuna, të cilët do të trajnohen në punë. Në përfundim të trajnimeve disa prej kandidatëve do të kenë mundësi të punësohen tek kompanitë partnere prodhuese të klubit. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është promovimi i përfshirjes sociale të rinjve të papunësuar nëpërmjet sigurimit të mbështetjes dhe aftësimit profesional të tyre në tregun e punës", është thënë në njoftimin e Klubit të Prodhuesve të Kosovës. Sipas këtij njoftimi, gjatë javëve në vazhdim KPK-ja do të njoftojë se kur do të hapen edhe aplikimet për pranimin e kandidatëve në secilën komunë në të cilën parashihet implementimi i këtij programi.

Aprovohet projekti 'Zhvendosja e gypave të azbestit' për KRU 'Gjakova'

PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Pas zotimit të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, për ta shtyrë përpara çështjen për trajtimin e gypave të azbestit në Ujësjellësin Rajonal "Gjakova" sh. a., është aprovuar projekti "Zhvendosja e gypave të azbestit". Ky projekt është aprovuar nga Këshilli Kombëtar i Investimeve i mbajtur më datë 13. 7. 2018 për financim përmes programit Soft Loan - huamarrje e butë me autoritetet hungareze, konkretisht lloji i financimit në kuadër të marrëveshjes huamarrje shtetërore sipas Ligjit për borxhin publik", është

thënë në komunikatën e MZHE-së. Sipas kësaj komunikate, Qeveria e Kosovës ka të rregulluar me autoritetet hungareze bashkëpunimin financiar përmes Ligjit nr. 05/L - 153 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë hungareze për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar e nënshkruar në dhjetor të vitit 2016. "Kjo marrëveshje parasheh hapa konkretë të implementimit ku nuk do të mungojë mbështetja e ministrit Valdrin Lluka edhe më tutje", është theksuar në komunikatën e MZHE-së.



ShKÇAK-u dhe OEAK-u: Ligji i ri për kontabilitet lufton informalitetin



PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), në bashkëpunim me Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), kanë organizuar të mërkurën tryezë me përfaqësues të bizneseve anëtare të OEAK-ut me qëllim të informimit të tyre mbi kërkesat e Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim si dhe diskutimit të sfidave që mund të dalin gjatë implementimit të këtij ligji. Kontabiliteti, raportimi financiar dhe auditimi konsiderohen thelbësorë për aftësimin e organizatave për të marrë vendime të

informuara të biznesit bazuar në performancën e kaluar dhe atë të tashme financiare. Kështu është thënë në tryezën e organizuar nga OEAK-u dhe ShKÇAK-u. Sipas OEAK-ut, duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre elementeve, më 19 prill 2019 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar Ligjin nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, i cili ka për qëllim ta rregullojë sistemin e kontabilitetit dhe raportimeve financiare të organizatave të biznesit, kërkesat për auditim, kualifikimet e nevojshme për kontabilistët dhe licencimin e auditorëve.

Sigurohen 3.8 milionë euro për sektorin e bujqësisë

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) dhe USAID-i kanë arritur marrëveshje për mbështetjen e sektorit të bujqësisë në vend. Përmes kësaj marrëveshje do të krijohet një program i veçantë për mbështetjen e zinxhirit të vlerave të frutave të imëta dhe bimëve mjekësore dhe aromatike në Kosovë për implementimin e të cilit është siguruar një fond prej 3.8 milionë eurosh

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 GUSHT - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) dhe drejtoresha e Misionit të USAID-it në Kosovë, Lisa Magno në Kosovë, kanë nënshkruar të mërkurën marrëveshjen e mirëbesimit për mbështetjen e sektorit të bujqësisë në vend. Përmes kësaj marrëveshje do të krijohet një program i veçantë për mbështetjen e zinxhirit të vlerave të frutave të imëta dhe bimëve mjekësore dhe aromatike në Kosovë për implementimin e të cilit është siguruar një fond prej 3.8 milionë eurosh. Bazuar në këtë marrëveshje, synohet zhvillimi ekonomik e bujqësor i vendit, rritja e prodhimit bujqësor e, bashkë me këtë, edhe rritja e të ardhurave të fermerëve si dhe krijimi i vendeve të reja të punës. Me rastin e nënshkrimit të kësaj

marrëveshje, ministri i MBPZhR-së, Nenad Rikalo, ka thënë se bashkëpunimi i ministrisë me partnerët ndërkombëtarë nga viti në vit ka dhënë dhe po jep rezultate shumë pozitive për zhvillimin dhe avancimin e sektorit bujqësor. "Kjo marrëveshje e bashkëpunimit me USAID-in është shumë e rëndësishme pasi përmes saj kemi arritur të kemi një kontratë trevjeçare, e cila garanton mbështetjen e prodhuesve tanë bujqësorë që merren me kultivimin e mjedrave, manaferrave e bashkë me këtë synojmë që, përveç rritjes së prodhimit, ta shtojmë edhe cilësinë e këtyre prodhimeve. Po ashtu, synojmë edhe ta rrisim mundësinë e eksportit të këtyre prodhimeve në tregjet e huaja, si dhe të ndihmojmë në krijimin e kontratave afatgjata që garantojnë sigurinë e këtyre prodhimeve", ka thënë Rikalo. Ai ka falënderuar USAID-in për mbështetjen e vazhdueshme që



po e jep për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë. Ndërsa drejtoresha e Misionit të USAID-it në Kosovë, Lisa Magno, ka theksuar se USAID-i do të vazhdojë ta mbështesë sektorin e bujqësisë dhe në përgjithësi zhvillimin ekonomik në Kosovë. Përmes këtij partneriteti ajo ka pohuar se kanë për qëllim ta rrisin sasinë dhe cilësinë e prodhimit bujqësor. "Tani po hymë

në një partneritet të drejtpërdrejtë me Qeverinë e Kosovës, konkretisht me Ministrinë e Bujqësisë, që në afat të shkurtër synohet ta risim prodhimin dhe eksportin, mirëpo përtej kësaj ne e shohim partneritetin me Ministrinë e Bujqësisë si një mundësi që t'i ndihmojmë ministrit dhe ekipit të tij t'i shënjestrojnë më mirë ato asetet që i kanë dhe t'i shfrytëzojnë ato

më mirë. Jemi shumë mirënjohës për bashkëpunimin që kemi pasur me ministrin dhe me shumë dëshirë presim bashkëpunim edhe në të ardhmen për t'i ndihmuar Kosovës", ka thënë ajo, duke shtuar se bujqësia është një pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik dhe kjo mund të bëjë ndryshime në jetën e qytetarëve të Kosovës.



Lekaj: Autostrada 'Arbën Xhaferi' do të përfundojë më 31 dhjetor të këtij viti

PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka realizuar një vizitë inspektuese në segmentin e fundit të autostradës 'Arbën Xhaferi', me ç'rast ka inspektuar punimet që janë duke u realizuar në urën më të gjatë në rajon. Lekaj ka thënë se është i kënaqur me punët që janë bërë dhe po bëhen. Ministri ka pohuar se përmbyllja e infrastrukturës rrugore ka ndikim në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e potencialit turistik në vend si dhe, sipas tij, krijon lidhje të korridoreve që e rrethojnë Kosovën. Lekaj ka thënë se janë të përkushtuar ta ndryshojnë politikën e deritashme kur projektet janë stërzgatur, duke ripohuar edhe një herë se kjo autostradë do të përfundojë më 31 dhjetor të këtij viti.

Latifi kërkon respektim të orarit të punës nga punonjësit e administratës komunale

RAHOVEC, 8 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur takim me të gjithë punonjësit e administratës komunale, me të cilët ka biseduar për respektimin e orarit të punës dhe angazhimin e tyre për kryerjen e punëve me më

efikasitet. Latifi gjatë takimit u ka kërkuar punonjësve të administratës ta respektojnë orarin e punës. "Siç ju e dini, orari i punës fillon në orën 8:00 dhe përfundon në orën 16:00, përfshirë këtu edhe pushimin nga ora 12:00 deri në orën 13:00. Bazuar në sistemin e

vijueshmërisë së punonjësve në punë, ka raste që punëtori vjen në punë pas orës 8:00 dhe del nga puna para orës 16:00. Ju njoftoj se ata punonjës që nuk e respektojnë orarin e punës do të marrin vërejtje dhe sigurisht se nga muaji shtator do të fillohet heqja e

mëditjeve nga paga juaj", ka thënë Latifi. Ai ka shtuar se respektimi i orarit të punës do të ndikojë edhe në rritjen e efikasitetit, në kryerjen e punëve karshi qytetarëve. "Ka ankesa nga ana e qytetarëve për mospraninë tuaj në punë", ka thënë Latifi.



Ministria e Mjedisit do të investojë 80 mijë euro në Kamenicë

KAMENICË, 8 GUSHT (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, së bashku me kryetarin e Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi për realizimin e projektit "Ndërtimi i ujësjellësit - Kamenicë, rruga për Tugjec", i cili ka vlerën prej 80 mijë eurosh dhe financohet nga kjo ministri.

Në ceremoninë e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, Matoshi ka thënë se qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i

kushteve të jetesës për qytetarët e Kamenicës. Ndërsa kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka falënderuar Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për këtë projekt të cilin e ka vlerësuar të domosdoshëm për qytetarët e kësaj komune. "Komuna e Kamenicës është komuna më e varfër sa iu përket ujërave në Kosovë dhe ka nevojë shumë të investohet si në çështjen e ujëmbledhësve, po ashtu edhe çështjen e rrjetit. Është një projekt shumë domethënës për ne", ka thënë Kastrati.



MPB-ja dhe Komuna e Obiliqit nënshkruan memorandum të bashkëpunimit



PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme dhe Komuna e Obiliqit kanë nënshkruar të mërkurën memorandum bashkëpunimi, i cili është nënshkruar nga ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi dhe kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi. Qëllimi i memorandumit të bashkëpunimit është lejimi i shfrytëzimit të hapësirës së paraparë në ndërtesën e MPB-së/ARC-së që është në territorin e komunës së Obiliqit, për Zyrat e Gjendjes Civile. Në bazë të këtij memorandumit, krahas shërbimeve për aplikim për lëshimin e letërnjoftimeve, pasaportave, patentë shoferëve

dhe regjistrimit të automjeteve, kjo hapësirë do të shfrytëzohet edhe nga Zyrat e Gjendjes Civile, të cilat e bëjnë regjistrimin e fakteve të lindjes, martesës dhe vdekjes, si dhe lëshimin e dokumenteve të tjera të gjendjes civile të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi. Pas nënshkrimit, ministri i MPB-së, Bejtush Gashi dhe kryetari i Obiliqit, Xhafer Gashi, theksuan se ky memorandum po bëhet me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve për qytetarët të cilët do të kenë mundësi që brenda një objekti t'i nxjerrin dokumentet e gjendjes civile dhe të aplikojnë për dokumente personale.

Komuna e Malishevës u ndan 70 fermerëve makina mjelëse

MALISHEVË, 8 GUSHT (ER) - Në kuadër të përkrahjes për bujqit lokalë, Komuna e Malishevës ka ndarë 70 makina mjelëse për fermerët. Nën kryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka bërë me dije se sektori i bujqësisë do të vazhdojë të mbetet prioritet për qeverisjen komunale. "Bujqësia është prioritet i qeverisë komunale dhe këtë lloj të përkrahjes do ta keni

edhe në vitet e ardhshme. Ju uroj se në rend të parë të keni shëndet dhe t'i gëzoni këto makina të cilat ju nevojiten", ka thënë Berisha gjatë ndarjes së makinave mjelëse për fermerët e Komunës së Malishevës. Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha, i cili i ka uruar fermerët, ka theksuar se drejtorja që drejton është duke u munduar që në

vazhdimësi të sigurojë përkrahje si në mekanizëm për fermerët, po ashtu edhe me subvencione të tjera. Ai ka pohuar se bujqësia vazhdon të mbetet fusha kryesore e zhvillimit ekonomik. Sipas drejtorit Hoxha, në këtë projekt janë përkrahur 70 fermerë ose pronarë të fermave të mëdha apo të vogla me makina mjelëse. Vlera totale e këtij projekti është 11 830 euro.



Ngjarje tragjike në Gjakovë, 43-vjeçari vret gruan dhe vajzën

Në rrethana ende të pasqaruar një 43-vjeçar nga fshati Bitesh i Komunës së Gjakovës ka qëlluar për vdekje të martën në mbrëmje bashkëshorten dhe vajzën e tij të moshës nëntëvjeçare. Këtë vrasje të dyfishtë e kanë dënuar përfaqësues të shtetit dhe të shoqërisë civile

GJAKOVË, 8 GUSHT (ER) - Prokuroria Themelore e Gjakovës ka njoftuar përmes një komunikate për medie se më 7 gusht, i dyshuari P. N., 43-vjeçar nga fshati Bitesh i Komunës së Gjakovës, ka shkuar në shtëpinë e familjes së bashkëshortes pas orës 21:00 në lagjen Brekoc të Gjakovës dhe me armën e tipit kallashnikov ka privuar nga jeta bashkëshorten e tij, V. N., 43 vjeçe dhe vajzën e vet të mitur, K. N., 9 vjeçe. "I dyshuari është ndaluar me urdhër të krye-prokurorit Ali Selimaj, i cili, së bashku me njësitë e policore rajonale, ka dalë në vendin e ngjarjes rreth orës 22:00, me ç'rast është bërë këqyrja e vendit të ngjarjes. Pas kërkimeve të shumta, është gjetur edhe arma, me të cilën dyshohet se i dyshuari ka kryer aktin kriminal", thuhet në komunikatën e Prokurorisë Themelore të Gjakovës.

Në këtë komunikatë bëhet me dije se "me urdhër të prokurorit trupat e pajetë të viktimave janë marrë nga zyrtarët e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë për ta kryer autopsinë. I pandehuri është në ndalim dhe ndaj tij do të kërkohet të caktohet masa për sigurimin e tij në procedurë. Hetimet në vazhdim do të tregojnë se cili ka qenë motivi i vërtetë i këtij krimi makabër", është theksuar në komunikatën e Prokurorisë Themelore të Gjakovës.

Ndaj kësaj vrasje të dyfishtë ka reaguar presidenti Hashim

Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Të gjithë janë shprehur të tronditur nga ky rast dhe kanë kërkuar të merren masa ndaj atyre që e kanë neglizhuar dhunën ndaj gruas. "I tronditur nga akti makabër në fshatin Brekoc të Gjakovës, ku humbën jetën një nënë dhe vajza e saj. Kërkoj të merren masa ndaj atyre që neglizhuan rastin, duke mos parandaluar krimin. Siguria e qytetarëve tanë duhet të jetë prioriteti i të gjitha institucioneve tona", ka shkruar presidenti Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka reaguar ndaj kësaj vrasje të dyfishtë që ndodhi të martën mbrëmë në Komunën e Gjakovës. RrGK-ja i ka bërë thirrje shoqërisë dhe institucioneve shtetërore t'i parandalojnë vrasjet e grave. "Të indinjua nga papërgjegjësia e organeve të rendit dhe sigurisë, të shqetësuara nga mosinteresi mi për jetën e grave dhe vajzave në vendin tonë, të tmerruara nga vrasjet makabre që po u bëhen grave dhe vajzave, Rrjeti i Grave të Kosovës i bën thirrje shoqërisë së Kosovës mjaft më me vrasjen e grave dhe vajzave. Mjaft më me arsyetimin e dhunës! Mjaft më me tolerimin e dhunës! Mjaft më me lirimimin e dhunuesve! Mjaft më me dëshitime në prurje të drejtësisë dhe në mbrojtje të qytetarëve të



Kosovës!", është thënë në reagimin e RrGK-së.

Sipas burimeve të RrGK-së, vrasësi kohë më parë ishte mbajtur në paraburgim (maj 2018) për ushtrim të dhunës në familje ndaj së ndjerës për veprën penale "Lëndim i lehtë trupor". "Policia e Kosovës ka qenë në dijeni për historikun e tij prej kriminel, përderisa gjykata e kishte liruar pas një muaji mbajtje paraburgim", është thënë në reagimin e RrGK-së.

Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka dënuar fuqishëm vrasjen e dyfishtë në Brekoc të Gjakovës. "Mbrëmë akti makabër në Gjakovë, ku u vranë nëna dhe bija e saj, është tronditje për të gjithë qytetarët dhe institucionet e vendit. Si nënë, grua, qytetare e këtij vendi dhe Ministre e Qeverisë së Republikës e dënoj fuqishëm këtë akt", ka shkruar ministrja në "Facebook". Hoxha ka thënë se ky rast duhet ta ngjallë ndërgjegjësimin për ndaljen e dhunës ndaj gruas dhe fëmijës.

Tahiri: Ata që nuk u ofruan siguri të ndjerave do të dalin para përgjegjësive

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka shprehur shqetësimet e thella rreth kësaj ngjarje të rëndë. Tahiri ka vlerësuar se papërgjegjësia, neglizhenca dhe moszbatimi i detyrave nuk ka vend në asnjë institucion, veçmas atyre që kanë për mandat ofrimin e mbrojtjes dhe sigurisë së jetës, pronës dhe të drejtave themelore të qytetarëve dhe se çdo papërgjegjësi e tillë duhet të trajtohet seriozisht dhe të ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi. "Nuk është e drejtë të gjykohej puna e palodhshme e Policisë së Kosovës në tërësi, por çdo rrethanë dhe çdo person zyrtar në rast injorimi të rrezikut të paralajmëruar duhet të mbahet përgjegjës. Policia e Kosovës ka nevojë për një hartë të parandalimit të krimit dhe një plan për të ditur saktësisht se sa

kohë efektive i duhet për të qenë në vend të ngjarjes, kudo që shfaqet rreziku dhe kanosja ndaj jetës së qytetarëve të Kosovës kudo qofshin ata", ka deklaruar Tahiri. Ai ka theksuar se në Republikën e Kosovës papërgjegjësia në sektorin e sundimit të rendit dhe ligjit nuk do të ketë vend. Tahiri u ka bërë thirrje të gjitha institucioneve të reflektojnë në këtë drejtim, mandati dhe legjitimiteti i të cilave buron nga aftësia për ta mbrojtur jetën, pronën dhe të drejtat themelore të qytetarëve. Ministria e Drejtësisë dhe ministri Tahiri ka shprehur angazhimin e plotë për bashkëpunim me të gjitha institucionet me qëllim të përmbushjes kuptimplotë të mandatit që ka sundimi i rendit dhe ligjit në Republikën e Kosovës.

Ambasada e Japonisë i dhuron QKMF-së në Mitrovicë një autoambulancë

MITROVICË, 8 GUSHT (ER) - Qeveria e Japonisë, në kuadër të projekteve bazike për siguri njerëzore dhe kulturë, ka ndihmuar QKMF-në e Mitrovicës me një autoambulancë. Në ceremoninë e dorëzimit-pranimit të autoambulancës, përveç kryetarit të Mitrovicës, Agim Bahtiri, ishin edhe drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani dhe drejtori i QKMF-së, Fevzi Sylejmani. Me këtë rast kryetari Bahtiri ka falënderuar Qeverinë e Japonisë për donacionin e dhënë për shëndetësinë e Mitrovicës, duke thënë se ndihmesa të tilla janë të rëndësishme për ta rritur efika-

sitetin e punës dhe shpejtësinë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët tanë. Ndërsa drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani, ka thënë se është plotësisht e nevojshme që ka pasur shëndetësinë në Mitrovicë. "Kemi pranuar një donacion nga Qeveria e Japonisë, një autoambulancë me të gjitha pajisjet e nevojshme që i përkasin emergjencës. Ajo ka vlerë shumë të madhe dhe e falënderoj Qeverinë e Japonisë për mbështetjen që na ka dhënë", është shprehur drejtoresha Barani.



Ndërsa Fevzi Sylejmani, drejtor i QKMF-së në Mitrovicë, ka thënë se ky donacion është tepër i nevojshëm për pacientët eventualë. Komuna e Mitrovicës është përfituese e një autoambulancë dhe pajisjeve mjekësore për laboratorin e QKMF-së në kuadër të projektit për përmirësimin e shëndetit publik që arrin vlerën mbi tetëdhjetë mijë euro. Qeveria e Japonisë do të mbështesë dhe të financojë në Kosovë shtatë projekte të cilat kapin vlerën e më shumë se 470 mijë euro të cilat kanë të bëjnë me zhvillim ekonomik, media, të rinj, kulturë dhe sport.

Conte ka kërkuar nga Trumpi informacione për sanksionet ndaj Iranit



ROMË, 8 GUSHT - Kryeministri i Italisë, Giuseppe Conte, thotë se ai e ka pyetur presidentin e Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, lidhur me gjetjet e inteligjencës që mund të qëndrojnë pas vendimit të ShBA-së për të rivendosur sanksione ndaj Iranit.

Conte tha se këtë kërkesë ia kishte bërë Trumpit gjatë vizitës

së tij në Uashington. Ai shtoi se Italia është e gatshme ta rishqyrtojë marrëveshjen bërthamore të vitit 2015 të arritur në mes të Iranit dhe fuqive botërore, marrëveshje nga e cila është tërhequr ShBA-ja. "Nëse e nënshkruani një marrëveshje nuk mund të thoni se nuk jeni të interesuar të kuptoni nëse ajo është efektive", tha kryeministri

italian.

Marrëveshja bërthamore e vitit 2015 i mundësonte Teheranit lehtësim të sanksioneve, në këmbim të frenimit të programit bërthamor. Trumpi në muajin maj njoftoi se Uashingtoni tërhiqet nga kjo marrëveshje. Në mesnatën e 7 gushtit ka nisur së zbatuari vala e parë e sanksioneve amerikane kundër Iranit.

Një paqe e brishtë, 10 vjet pas konfliktit Rusi - Gjeorgji

MOSKË, 8 GUSHT - Këtë javë mbushen dhjetë vjet prej kur filloi lufta në mes të Rusisë dhe Gjeorgjisë për kontroll në Osetinë e Jugut, një rajon i vogël, separatist në Gjeorgji, të cilin Moskë më pas e njohu si territor të pavarur. Megjithatë konflikti zgjati vetëm pesë ditë, lufta la qindra civilë të vrarë dhe mbi 20 mijë veta pa strehë. Por, jehona e konfliktit ndihet ende sot.

Në ish-Bashkimin Sovjetik zyrtarët vazhdimisht i mbulonin dallimet mes rusëve e gjeorgjianëve, bazuar në politikën sovjetike të Stalinit për t'i shuar ndarjet etnike. Por këto dallime u ndezën në gusht të 2008-s, kur shpërthyen luftimet në mes të Rusisë dhe Gjeorgjisë, të cilat fajesonin njëra-tjetrën si shaktare të konfliktit. Një ndër faktorët që e ushqeu konfliktin ishin tensionet gjeopolitike, ndërkohë që presidenti gjeorgjian Mikhail Sakashvili ndiqte politika pro-perëndimore me synimin për anëtarësim në NATO, duke acaruar tensionet dhe shqetësimet e Kremlinit, i cili u hodh në veprim. "Ishte një përpjekje për t'u treguar të gjithëve se Rusia ishte në gjend-

je të bënte shumë gjëra: të ndërhynte ushtarakisht, të organizonte operacione agresioni në një territor ish-sovjetik. Ishte një reagim i papritur", thotë Alexey Malashenko i Universitetit "Northeastern".

Rusia e sprapsi Ushtrinë gjeorgjiane brenda pesë ditësh, por u ndesh me revoltim të komunitetit ndërkombëtar, kur njohu pavarësinë e Abkazit dhe Osetisë Jugore, dy rajone separatiste gjeorgjiane.

Me gjithë fitoren, Moskë shqetësohej për mangësitë në fushën e betejës. "Lufta në Gjeorgji nxiti një program masiv dhe të kushtueshëm për riarmatimin e rusëve pasi, megjithatë e fituan luftën, nuk u pa si një përmbytje cilësore e misionit. Nuk u arritën objektivat politike dhe strategjike", thotë Pavel Felgenhauer, analist për mbrojtjen.

Këto mësimet u shërbyen rusëve në Ukrainë, një tjetër republikë ish-sovjetike që po avanconte drejt integritet perëndimor. Kur Rusia aneksoi Krimenë në 2014-n dhe plasi konflikti në Ukrainën Lindore, në fushëbetjeje u pa një



Ushtri ruse shumë më e fuqishme.

"Këtë radhë Rusia kishte një ushtri të pajisur shumë më mirë, shumë më të përgatitur dhe me prapavijë më të mirë", thotë analisti Felgenhauer.

Me kalimin e viteve, marrëdhëniet mes rusëve dhe gjeorgjianëve janë përmirësuar. Janë shtuar shkëmbimet tregtare dhe turistike. Dhe

kultura gjeorgjiane është e pranishme kudo, edhe në Moskë. Por, ambiciet gjeorgjiane për anëtarësim në NATO mund t'i rindezin gjakrat. Po ashtu, statusi i rajoneve separatiste të Gjeorgjisë dhe trupat ruse të dislokuara atje mbeten mullë shërri. "Askush në Gjeorgji nuk do luftë. Njerëzit duan paqe, por kjo s'do të thotë se gjeorgjianët do të pranojnë paqe

dhe marrëdhënie të mira me Rusinë, duke hequr dorë nga pjesë të territorit të tyre", thotë një prift i kishës gjeorgjiane në Moskë. Dhjetë vjet pas shpërthimit të konfliktit, që njihet si "lufta e vogël e Rusisë me Gjeorgjinë", mbizotëron një paqe e brishtë. Dhe, siç shprehen disa në Moskë, do të duhen më shumë se lutje për ta ruajtur këtë paqe.

Fituesi i zgjedhjeve në Ohajo, ende i pashpallur



Ohajo, 8 gusht - Fituesi i zgjedhjeve të posaçme për një vend në Dhomën e Përfaqësuesve nga Ohajo nuk është shpallur ende pasi rezultati është shumë i ngushtë. Votimi u ndoq me interes të veçantë dhe republikanët dhe demokratët komentuan për këtë garë dhe votime të tjera paraprake në vend, në përpjekje për të parashikuar se si do të shkojnë zgjedhjet e Kongresit në nëntor.

Republikani Troy Balderson, një senator i këtij shteti për dy mandate dhe demokrati Danny O'Connor, protokollisti i distriktit Franklin, kishin vetëm një diferencë të vogël.

Ndërsa numërimi i votave nuk ka mbaruar, mungesa e qartësisë nuk i pengoi kandidatët të flisnin me nota optimiste. "Jemi në barazim dhe ju ishit ata që e bëtë të mundur. Vullnetarët që shkuan derë me derë për të

luftuar për të ardhmen e vendit tonë. Jam shumë mirënjohës për mbështetjen tuaj, ju kishit besim te ne, në një garë për të cilën kishim thënë se nuk kishim asnjë shans", tha ai.

Presidenti Trump deklaroi fitore në emër të Balderson në "Twitter", duke marrë meritën për një takim fushate që ai bëri momentin e fundit, në distriktin ku ai kishte fituar me 11 pikë epërsi.

Ivan Duque betohet si president i ri i Kolumbisë

BOGOTA, 8 GUSHT - Ivan Duque ka bërë betimin si president i ri i Kolumbisë, duke u zotuar se do ta bashkojë shtetin si dhe do ta përmirësojë rritjen ekonomike.

Politikani konservator ka fituar zgjedhjet në muajin qershor, pas një fushate përçarëse, në të

cilin ka triumfuar ndaj rivalit të tij të krahut të majtë, Gustavo Petro.

Gjatë fjalimit të tij në ceremoninë inauguruese, ish-avokati ka premtuar se do ta luftojë korrupsionin dhe do ta forcojë ekonominë. Lideri, po ashtu, është zotuar se do ta ndryshojë

marrëveshjen për paqe me grupin rebel, Farc.

Presidenti në shkuarje i këtij vendi, Juan Manuel Santos, i ka bërë thirrje Duques ta respektojë marrëveshjen, e cila është negociuar më 2016, duke i dhënë fund një konflikti civil që ka zgjatuar për pesë dekada.

Forcat Revolucionare të Armatosura të Kolumbisë, (Farc), tani janë shndërruar në parti politike. Një pjesë e anëtarëve të saj kanë fituar ulëse në parlament muajin e kaluar për shkak të kushteve paraprake që u sigurojnë atyre përfaqësim në parlament.



Qasje një vepre të re - dramë

Vrasja e mësuesit

(Riza Greiçevci: **"Lulëkuqja e Kosovës"**, dramë: Jeta, veprimtaria atdhetare e Fazli Greiçevcit, qëndresa, vrasja mizore e mësuesit, përprjekja e dr. Slavisha Nikoliqit, për të fshehur krimin, rrëfime tronditëse të te burgosurit në qelinë nr.4, Hazir Krasniqi (aty, ku, vetëm për tri ditë, kriminelët serbë ia morën frymën e shpirtit, Fazliut), burrëria, trimëria e dr. Ali Sokolit, varrimi pa asnjë anëtar të familjes, më 17 gusht 1991, manifestimi gjithëpopullor: zhvarrosja dhe rivarrosja e eshtrave të mësuesit, pas 33 vjetësh, amaneti i vëllait për gjashtë motra...)

Shkruan: Zekë MURSELI


Doli nga shtypi libri më i ri i shkrimtarit drenicar, Riza Greiçevci, **"Lulëkuqja e Kosovës"**, një dramë për dramën e shembjes së jetës së mësuesit e poetit Fazli Greiçevci, por hedh dritë edhe në jetën familjare, shkollore, pa harruar veprimtarinë atdhetare, si njëri nga krahët më të fortë jo vetëm të LRBSH-se, të Adem Demaçit, për territorin e Drenicës, dhe gjithandej.

Riza Greiçevci, përveç mbi 106 veprave të botuara gjinësh të ndryshme letrare, botoi edhe këto vepra dramatike: **"Deri në vdekje"**, **"Arbania e Vogël"**, **"Ushtrimë malesh"**, **"Dasmë në male"**, **"Pushka"**, **"Tringa e Prekazit"**, për t'iu shtuar këtij kopshti letrar të dramaturgisë shqiptare, edhe vepra më e re, një dramë me nëntë pamje **"Lulëkuqja e Kosovës"**, e ky botim vjen menjëherë pa daljes në dritë të kompletit prej pesë librave, (po të këtij autori), kushtuar Fazli Greiçevcit.

Dëshmitari i qelisë nr. 4, rrëfen mizoritë e çetnikëve serbë mbi trupin e jetën e mësuesit Fazli Greiçevci

E dija se ujët fle, Riza nuk fle! E dija se kësaj vere do të përfundonte shkrimin e tekstit të një drame për një dramë tmerrësisht të vërtetë, por aq sa e tmerrshme, aq e dhembshme: Vrasja e një mësuesi të ri drenicar, një poeti, vargjet poetike të te cilit kishin bërë jehonë, vritet mizorisht për tri ditë e tri net, pa i dhënë asnjë ndihmë mjekësore djaloshtit në komë, në qelinë nr.4, të Burgut të Prishtinës, vritet nga dora kriminelit Valada Sheligoviç, lindur në Glllogoc të Drenicës, i ndihmuar edhe nga shqipfolës e kriminelë të tjerë serbë, shuhet jeta rinore e një mësuesi, që aq sa jetën e Zotin e lirinë e deshi flamurin kombëtar! Për lexuesit e "Epokës së Re", po sjellim vetëm një metodë barbare, përtej egërsisë shtazore, për të poshtëruar dinjitetin e moralin e një mësuesi shqiptar, kriminelët serbë-çetnikë, ia sjellin flamurin kuqezi para syve, i hedhin ujë të ftohtë në kokë, e kur i duken bebëzat e syve, shikon flamurin kombëtar mbi tokë, dhe, në fytyrën e tij, shpreh një xixinë buzëqeshjeje e fundit, kurse kriminelët i çjerrën:

*"Shkile, i thanë, me këmbë flamurin!
pështyje, i thanë, me gojë flamurin!
shaje, i thanë, me nanë flamurin!
shkyeje, i thanë, me duar flamurin
preja kryet, sorrës, shkabë
në daç motrat, vëlla e babë!*



*në daç jetën me ta falë,
tregoj shokët, fis e farë.."*

Tekstin e dramës **"Lulëkuqja e Kosovës"**, shkrimtari e publicisti, Riza Greiçevci, jo nuk e shkroi vetëm sa për të treguar shembjen e një të riu drenicar, por, autori me përpikëri, hollësisht, me një përkushtim e përvojë të gjatë, me një kulturë e të te shkruarit të veçantë të dramës, hedh në skenë (shesh) fuqishëm momentet më reale, të thithura nga Dosja sekrete e Fazliut, veçmas nga dëshmitari Hazir Krasniqi, i burgosur po ashtu në qelinë nr.4, rrëfimet e të cilit, përpikërisht, me guxim, ishin dhe mbetën shtyllat kryesore të së vërtetës, përkitazi me keqtrajtimin më mizor, barabar, kanibalist, të kriminelëve serbë, duke kërkuar nga mësuesi e poeti Fazli të tregojë shokët e idealit, të hedhë në shesh tërë veprimtarinë patriotike të Adem Demaçit, dhe të bashkëpunëtorëve e shokëve të tij, por, para gjykatësit hetues, Qazim Tolaj, vetë kriminelin Magovçevic, e kishte pranuar, se mësuesi nga Drenica, në vend të përgjigjeve "pozitive", buzëqeshte, dhe, kaq! Mbyllte sytë, heshtte! Njeri më të fortë, njeri që e do më shumë se jetën, flamurin kombëtar shqiptar, jo, jo, nuk ka lindur nana shqiptare.

Vrasja e mësuesit

Dëshmitari i qelisë nr.4, Hazir Krasniqi, tregon qysh e urdhëruan me plumb në kokë për ta ushqyer mësuesin, i larë në gjak, në komë, pa hëngër pa pi tri dite e tri net, pa asnjë ndihmë të mjekut, pa asnjë ilaçe, tregon të vërtetën e vrasjes së mësuesit Fazli, e thotë me bindje se, kriminelin serb, dr. Slavisha Nikoliq, nënshkroi të pavërtetën, kinëse mësuesi drenicar paskësh vdekur në spital, nga veremi, kurse, dr. Ali Sokoli, me gisht të hundët u kishte thënë kriminelëve serbë-çetnikë, se mësuesin nga Drenica e keni

vrarë ju vetë, s'ishte i sëmure nga veremi, kurrë s'e nënshkruaj kriminin mbi mësuesin e pafajshëm! Po ashtu, me këtë rrenë të dr. Nikoliqit, milicia serbe, tërë natën i bënë roje arkivolit ku ndodhej trupi i copëtuar i mësuesit Fazli (nga sandeki rridhte tërë natën, gjak i zi...! – vërejtja e autorit), duke alarmuar familjen e mësuesit të ndjerë, se ky njeri (mësuesi Fazli) vdiq nga një sëmundje tepër të rrezikshme për të gjallët!

Teksti (brumi) i kësaj vepre dramatike sjell në skenë disa qortime, përmirësime, korrigjime të vrasjes së mësuesit, sjell takimin e djalit, Flamurit (F.G.) me vendlindjen e babës Fazli, me familjen e ngushtë të tij, dhe shkuarjen, bashkë me nanën, Myrveten, në Turqi, për të mos e parmë kurrë, as vendlindjen, as varrin e babës Fazli, as Kosovën!

Edhe pse kjo vrasje e mësuesit Fazli, në qershor të vitit 1968, nga gjykatësi hetues i Gjyqit të Qarkut në Prishtinë, Qazim

Tolaj, (më 27.VI.1968) kishte filluar ndriçimin e vrasjes së mësuesit drenicar, edhe pas shumë seancave gjykimesh, e mbledhjes se fakteve e dëshmi e të sakta e të bollshme për vrasjen e kriminelit serb-çetnik, Valada Sheligoviç, s'dihet, as kush, as pse, as me urdhrin e kujt ky gjykim

u ndërpre sot e asaj dite! Kriminelin Sheligoviç, po atë ditë, në orën 16,00, lirohet nga burgu dhe ikën në Beograd. Varrimi i mësuesit bëhet pa praninë e asnjë anëtari të familjes, afër varrit të nanës së tij, Sherifes, duke e ruajtur një kohë të gjatë, ditën e natën, varrin e mësuesit, e keqja, nga shqipfolës...!

Pa dyshim, Riza bëri shumë mirë që hodhi mbi letër vrasjen e mësuesit Fazli Greiçevci, tash e ndriçuar me të dhëna, fakte, qortime e përmirësime të rrjedhave të tërë jetës, veprimtarisë, familjes, qëllimet e kriminelëve serbë për fshehjen e vrasjes së mësuesit, deri të zhvarrimi dhe rivarrimi i eshtrave (1991) të simbolit të flamurit, Lulëkuqes dhe Heroit të Kosovës, Fazli Greiçevci.

E rrallë

Një peshk i rrallë kapet në Borsh

Një peshk i rrallë i llojit "Dental" ka rënë në grepat e disa peshkatarëve amatorë në bregun e Borshit, në Vlorë. Peshku peshonte 12 kg dhe është i rrallë për ujërat e detit Jon. "Dentali" i



rrallë u kap me një seri grepash, në të cilët ishin vendosur kallamarë. "Dentali" ka një pamje të veçantë, pasi ngjyra e tij është rozë.

FOTO E DITES



Krokodilët pushojnë në një fermë në Luginën e Jordanit, në Bregun Perëndimor. /AP/

E jashtëzakonshme

Diplomimin e feston me aligatorin gjigant

Një studente në një kolegji në Amerikë është siguruar që postimet e saj nga ceremonia e diplomimit të jenë vërtet për t'u mbajtur mend, pasi me diplomën e saj në dorë ajo ka pozuar me një aligator rreth katër metra të gjatë. Makenzie Noland është studente në Universitetin A & M të Teksasit ku u diplomua



të premten me një diplomë në shkencat e kafshëve të egra dhe të peshkimit.

BARSOLETA E DITËS



- Djali: Sa vjet i ki?
- Vajza: Sa po m'i jep?
- Djali: Asnjë s'po ta jap, se edhe ashtu boll paske.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird




Në ora 18:20

"FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p>DASHI Entuziazmin e munguar po filloni ta gjeni përsëri sot në detaje të vogla dhe në ambientin e ngrohtë familjar.</p>	 <p>DEMI Po hidhni argumente që nuk jeni të gatshëm t'i mbështesni në ditët në vijim. Mbase një ndryshim strategjie do të ishte më i mirë.</p>	 <p>BINJAKËT Puna për ju sot do të jetë një burim kënaqësie. Bashkëpunimi me kolegët ju ka bërë të përfitonit mjaft të mira morale dhe materiale.</p>	 <p>GAFORRJA Po lini pas dore raportet tuaja personale, sidomos ato që u përkasin ndjenjave. Kur t'i kërkonte miqtë tuaj, do të vini re distancat.</p>	 <p>LUANI Nëse nuk jeni të kënaqur nga ajo që po bëni kohët e fundit, është mirë të ndaleni dhe të mendoni qartë se kush është prioriteti juaj.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Doni t'i vazhdoni projektet që keni nisur, por rrethanat nuk do t'ju lejojnë ta bëni këtë gjë. Ndryshoni drejtim në kohën e duhur.</p>
 <p>PESHORJA Gjëja më e mirë është heshtja kur shihni se përreth jush situatat dhe personat janë duke krijuar rrëmujë. Më pas gjithçka do të qartësohet.</p>	 <p>AKREPI Personat gri që rrinë rreth jush nuk kanë pasur asnjëherë asnjë ide dhe nuk ju kanë propozuar asgjë deri tani. Bëni mirë të bëni dallime.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot duhet të veproni vetëm për veten tuaj. Duke marrë rolin e të tjerëve i keni hequr vetes mundësitë të dëgjoheni në ambiente të ndryshme.</p>	 <p>BRICJAPI Jeni të pavarur në vendimet tuaja sot dhe kjo ju ka krijuar mjaft liri veprimi. Përfitimet e kësaj gjeje do t'i përjetojnë edhe familjarët tuaj.</p>	 <p>UJORI Keni kërkuar prej kohësh mënyrën më të mirë për të zgjidhur disa ngërçe që po verifikohen në ambientin e punës. Nëse nuk ia dilni, mbase është momenti të ndaloni.</p>	 <p>PESHQIT Keni zgjedhur një rrugë të mesme sot për t'i arritur objektivat tuaja. Edhe pse do të keni kritika, jeni ju që merrni vendimet për veten.</p>

Kourtney Kardashian ndahet nga i dashuri



Kourtney Kardashian dhe Younes Bendjima janë ndarë pas 18 muajsh lidhje. Sipas "TMZ"-së, ata edhe nuk po e ndjekin më njëri-tjetrit në "Instagram". "TMZ" ka raportuar se Kourtney ishte shkaktarja e ndarjes së çiftit. Ata e kishin filluar lidhjen në vitin 2016 pasi u takuan në një

bar në Paris dhe i kanë kaluar pushimet së bashku në Itali. Kourtney Kardashian dje është parë duke flirtuar me modelin Jordan Ozuna në Meksikë. Kjo lidhje ishte e para lidhje serioze e Kourtneyt pas ndarjes me Scott Disick në vitin 2015, i cili tashmë është në lidhje me 19-vjeçaren Socia Richie.

Pensionohet prej botës së filmave ylli i madh i Hollywoodit



"Një punë e fundit". Është ndër frazat që mund t'i dëgjojmë në filmin e ardhshëm "The Old Man & The Gun", ku në rolin kryesor mund ta shohim Robert Redfordin. Ky i fundit me të vërtetë e ka paraqitjen e fundit në ndonjë film hollivudian, pasi që ka vendosur të pensionohet

në moshën 81-vjeçare. Ai ka dhënë një intervistë për "EW" teksa ka konfirmuar largimin prej botës së industrisë së filmave. "Kurrë mos thuaj kurrë, por kam arritur në përfundimin se ky ishte filmi i fundit i imi pasi do të shkoj drejt pensionimit", ka thënë Redfordin.




Ronaldo hedh të dashurën nga jahti

Pushimet e Cristiano Ronaldos dhe Georgina Rodriguez duket se nuk kanë fund. Pas Italisë, çifti u fotografua në Ibiza, duke kaluar një ditë relaksuese në jahtin luksoz. Futbollisti 33-vjeçar është

fotografuar teksa shtynte të dashurën 24-vjeçare në det. Ata duken më të lumtur se kurrë nën shoqërinë e njëri-tjetrit. Modeluesja 24 vjeçe është në super formë vetëm pak kohë pas lindjes së vajzës.

Fejohet Gina Rodriguez



Gina Rodriguez dhe i dashuri i saj Joe LoCicero janë fejuar. 34-vjeçarja ka bërë me dije lajmin të martën për "Us Weekly".

"Unë kam një njeri shumë special në jetën time. Jam fejuar. Ju jeni të parët që jua tregova", ka thënë ajo. Gina dhe Joe janë takuar gjatë vitit 2016.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

RANGERS - MARIBOR

1

ISTANBUL BUYUKSEHIR - BURNLEY

1

SUBOTICA - BRONDBY

2

Veseli: Në vitin 2019 fillon ndërtimi i stadiumit kombëtar

Kadri Veseli gjatë vizitës të mërkurën që i ka bërë stadiumit "Fadil Vokrri" në Prishtinë ka thënë se punimet për stadiumin kombëtar në Drenas do të fillojnë në fillim të vitit 2019. "Ky projekt është në përfundim, më pas do të vazhdojmë në Mitrovicë, ndërsa stadiumi kombëtar do të fillojë në fillim të vitit të ardhshëm dhe do të jetë më i miri jo vetëm në Republikën e Kosovës, por edhe në regjion. Do t'i vazhdojmë investimet në terrene sportive në Prizren, Podujevë, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë dhe Pejë në mënyrë që të kemi sa më shumë stadione", ka thënë Veseli

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 GUSHT - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, të mërkurën e kanë vizituar stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, për ta parë nga afër përfundimin e punimeve.

Kryetari i Kuvendit, njëherësh kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, është ndarë i kënaqur me punimet që janë bërë në stadium që e bartë emrin e legjendës Fadil Vokrri. "Vetëm disa muaj më herët pakkush kishte besuar se do të kemi një stadium të tillë në qendër të Prishtinës. Ky është ndër projektet më të bukura të stadioneve që mund të transformoheshin në modernizim. Kemi hyrje, tribuna dhe fushë moderne. Kjo do të vazhdojë në gjithë Kosovën", ka thënë Veseli, i cili ka folur edhe për ish-kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri. "Urime të gjithëve stadiumi që mban emrin me emblemë të futbollit të Kosovës. Ne jemi rritur me legjendën Fadil Vokrri. Ai më nuk është në mesin tonë, por e kemi stadiumin që përjetë do ta mbajë emrin e tij dhe Vokrri do të jetë ideal për të rinjtë dhe të rejtat se si duhet të jetësh i suksesshëm në sport, por edhe pas përfundimit të karrierës", ka deklaruar Veseli, i cili nuk ka hezituuar të bëjë edhe një premtim të madh se në fillim të vitit të ardhshëm do të fillojnë punët në stadiumin kombëtar në Drenas, por do të ketë investime edhe në stadione të tjera nëpër Kosovë. "Ky projekt është në përfundim, më pas do të vazhdojmë në Mitrovicë, ndërsa stadiumi kombëtar do të fillojë në fillim të vitit të ardhshëm, i cili do të jetë më i miri jo vetëm në Republikën e Kosovës, por edhe në regjion. Do t'i vazhdo-



jmë investimet në terrene sportive në Prizren, Podujevë, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë dhe Pejë në mënyrë që të kemi sa më shumë stadione", ka pohuar Veseli.

"Herën e ardhshme Kosova synon të jetë pjesëmarrëse në Kampionatin Botëror dhe Evropian. Ne kemi talentë të jashtëzakonshëm dhe do t'i inkurajojmë dhe fuqizojmë, kurse sporti do të jetë prioriteti ynë. Liberalizimi i vizave në Republikën e Kosovës do të ndodhë, por rinia duhet të qëndrojë në Kosovë", ka shtuar Veseli.

Ndërsa numri një i MKRS-së, Kujtim Gashi, është i lumtur që Kosova tash e ka një stadium i cili i plotëson kushtet për kategorinë e katërt të UEFA-s. "Është një kënaqësi e veçantë të vizitojmë përfundimin e punimeve që kanë ndodhur në stadiumin 'Fadil Vokrri'. Siç e dini, para dy ditësh

UEFA ka dhënë dritën e gjelbër për t'u zhvilluar lojërat në këtë stadium. Është një arritur e madhe për Ministrinë e Sportit, por edhe Qeverinë e Kosovës që, më në fund, Kosova të ketë një stadium të kategorisë së katërt të UEFA-s. Për herë të parë në Kosovë do të luhen lojërat në Prishtinë, pasi deri tash i kemi zhvilluar lojërat në stadione të Shqipërisë. Më në fund stadiumi i legjendës, i njeriut që e ka iniciuar dhe ideuar këtë projekt, është gati, por është edhe një moment emocional, pasi më 13 gusht nuk do ta kemi legjendën, Fadil Vokrri, por do t'i kemi idetë dhe përkushtimin e tij", ka thënë deklaruar Gashi.

Superkupa e Kosovës në futboll në mes të Prishtinës dhe Dritës është ndeshja e parë që do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". Kjo ndeshje zhvillohet të hënën më 13 gusht në orën 20:00.

SHKURT

Prishtina, me mungesa në finalen e Superkupës

Prishtina dhe Drita takohen të hënën më 13 gusht me fillim nga ora 20:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" në ndeshjen finale të Superkupës. Prishtina do të ketë tri mungesa për shkak të suspendimeve. Dallku dhe Curri do të mungojnë edhe në dy ndeshje zyrtare, pasi në një ndeshje të finales së Kupës kanë munguar. Një tjetër mungesë është ajo e Meriton Korenicës. "Suspendimi më i çuditshëm është i Korenicës. Publiku i shumtë që pritet të jetë i pranishëm nuk do të mund ta shijojë paraqitjen e tij. Korenica me Lirinë ka katër karton të verdhë dhe, sipas rregullave, ndeshja e Superkupës e ka tretmanin e ndeshjes së fundit kampionale të edicionit paraprak të garave. Në këtë mënyrë trajtohen futbollistët e ndëshkuar me karton të verdhë apo të kuq", thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Mitrovica pësoi humbje në ndeshjen e parë të Ligës së Kampionëve

Skuadra kampione e Kosovës në Superligën e Femrave, Mitrovica, ka debutuar me humbje në Ligën e Kampionëve. Vashat mitrovicase kanë pësuar me rezultat të thellë 6:1 nga kampioni i Hungarisë, MRK Hungaria, në kuadër të grupit 4, ndeshjet e të cilit grup zhvillohen prej 7 deri më 13 gusht në Hungari. Ndeshjen e dytë Mitrovica do ta luajë më 10 gusht kundër kampiones së Çekisë, Slavia Pragë, kurse ndeshjen e tretë dhe të fundit në grup e luan kundër kampionit të Turqisë, Atasehir Belediyerspor, më 13 gusht.

Barça heq dorë nga Pogba

Skuadra kampione e La Ligës, Barcelona, ka hequr dorë nga transferimi i Paul Pogbas nga Manchester United. Lajmin e ka konfirmuar të mërkurën "Sport", kurse kjo tërheqje e Barcelonës ka ardhur si pasojë e asaj se Unitedi nuk dëshiron ta shesë yllin francez.

Ballkani kërkon ndihmën e bizneseve

Skuadra e Ballkanit që është rikthyer në elitën e futbollit të Kosovës ka kërkuar publikisht përkrahje nga bizneset e qytetit të Suharekës. Kjo skuadër ka synime të mëdha në elitën e futbollit të Kosovës, prandaj edhe ndihma financiare është e domosdoshme. "Të nderuar afaristë biznesorë të komunës sonë, individë të vullnetit të mirë si dhe futbolldashës, siç jeni në dijëni, FC Ballkani pas tetë vjetësh është rikthyer në Superligën e Kosovës, pas disa sezoneve të rënda të klubit. Fillimisht dëshirojmë t'ju përshëndesim dhe t'ju falënderojmë që keni kontribuar me vite të tëra për FC Ballkanin. Me inkuadrimit në Superligë, klubi ynë nuk e ka qëllim vetëm pjesëmarrjen, por me investimet e fundit, sidomos në infrastrukturë dhe afrimin e futbollistëve cilësorë brenda ekipit, kemi besim dhe synim kreun e tabelës, garat evropiane dhe, pse jo, titullin, që klubi ynë me histori 71-vjeçare nuk e ka shijuar asnjëherë. Por, që të arrihet deri tek suksesi, FC Ballkani ka nevojë për ndihmë morale dhe financiare nga të gjithë ne së bashku. Ftojme të gjithë afaristët e biznesit nga komuna jonë që të na bashkëngjiten në projektin tonë për një qëllim të përbashkët, prezantimi sa më i mirë i FC Ballkanit në Superligë", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Marquezi kërkon hakmarrje ndaj Ducatit

VJENË, 8 GUSHT - Marc Marquezi ende nuk i ka dalë inati për vendin e tretë në garën e Brno (Republika Çeke), ku u mposht nga dy motorët Ducati, në një garë të hapur dhe me rivalitet deri në kthesën e fundit. Në prag të

garës që do të zhvillohet këtë fundjavë në Austri, piloti spanjoll shpreson në një hakmarrje karshi motorit italian. "Kemi kryer disa teste të mira në Brno, ku provuam mjaft gjëra dhe morëm një përgjigje pozitive. Disa prej tyre do t'i

provojmë edhe në Austri, ku synojmë fitoren", ka thënë Marquezi. "Një vit më parë, këtu në Austri, e humba garën në kthesën e fundit, ashtu si në Çeki, ndaj këtë herë shpresoj që kthesa e fundit të jetë me fat për mua. Kjo është një

pistë ku nuk kam garuar shpesh, nuk e njoh shumë, por mund të arrijmë një rezultat të mirë", ka deklaruar piloti spanjoll i Hondas që kryeson Botërorin e Moto Gp me 49 pikë avantazh ndaj Valentino Rossit.



Historia e Jermaine Pennant, një adoleshencë mes bandave të krimit



LONDËR, 8 GUSHT - Ish-futbollisti i Arsenalit dhe Liverpoolit, Jermaine Pennant, zbulon për "Mirror" një pjesë të jetës së tij të trazuar përmes autobiografisë. Një jetë mes bandave të Notingemit ajo e 35-vjeçarit dhe një karriere futbollistike që kapërcente nga një problem te tjetri. Prindërit iu ndanë kur Jermaine Pennant ishte vetëm tre vjeç. Babai ishte një shpërndarës droge dhe raportet me nënën nuk ishin kurrë të qeta. Nuk foli me të për 10 vjet dhe mendonte për shumë kohë se

kishte vdekur, por në të vërtetë zbuloi vetëm së fundmi që ishte ende gjallë. "Edhe jemi takuar, por nuk kemi asnjë lloj marrëdhënieje. Në shkollë nuk shkëlqej, përveç sportit. E vetmja rrugë për t'u larguar ishte të bëhesha futbollist. Vetëm Zoti e di se çfarë do më kishte ndodhur po të kisha qëndruar atje". Dhe në lidhje me bandat lokale, ku ai bënte pjesë, ai tregon për një përplasje mes tyre në Notingem kur ishte vetëm 14 vjeç: "Kishin thika, shkopinj bejsbolli dhe pistoleta. Një herë tjetër ishim në një 'fast-

food'. Të gjithë u larguan, ndërsa banda jonë ndoqi atë rivale. Nuk e pashë çfarë ndodhi me sy, sepse u fsheha pas banakut, por një prej pjesëtarëve të bandës rivale u kap dhe vdiq më pas në spital". Ky ishte episodi që e largoi përfundimisht nga bota e krimit dhe e trembi futbollistin e ardhshëm, se mund të ishte ai në vend të tij. Një vit më vonë ai u bë adoleshenti më i shtrenjtë i futbollit. Firmosi me Arsenalin 15 vjeç më 1999, për të cilin "topçinjtë" paguan dy milionë sterlina.

Guardiola: City është përmirësuar

MANCHESTER, 8 GUSHT - Pep Guardiola ka paralajmëruar rivalët e Premierë Ligës se Manchester City i tij do të jetë më i përmirësuar se sezonin e kaluar, kur ia doli ta fitojë titullin kampion me diferencë të madhe pikësh nga ndjekësi më i afërt. Skuadra e Guardiols është sërish favorite për këtë trofe në Angli, ndërsa po përgatitet për ta nisur sezonin e ri në transfertën e Arsenalit të dielën. Trajneri katalanas shpreson të shohë edhe më shumë episode nga Manchester City, pasi beson se gjithmonë ka vend për përmirësim të lojtarëve të tillë si Sergio Aguero, Kevin De Bruyne dhe David Silva. "Çdo lojtar mund të jetë individualisht më i mirë, kështu që dikush që mund të xhirojë në mënyrë të përkryer me këmbën e tij të djathtë, mund ta bëjë këtë edhe me të majtën e tij. Kur përmirësoheni individualisht, ju keni përmirësuar edhe ekipin. Ju



nuk mund të keni një lojë të përsosur. Nuk ka në botë një ekip të përsosur. Gjithmonë mund të përmirësohesh në futboll". Megjithatë, Guardiola nuk pret të jetë një vit i lehtë për kampionët në fuqi të Anglisë, pasi rivalët e tyre do të jenë në formë edhe më të mirë:

"Ajo që ne kemi qenë në gjendje ta bëjmë sezonin e kaluar çdo ekip mund ta bëjë këtë, veçanërisht pesë kandidatët kryesorë. Manchester Unitedi, Chelsea, Arsenali, Tottenhami dhe Liverpooli do të jenë sfidues për ne", ka deklaruar Guardiola.

SHKURT

Llapi transferon Ahmed Januzin

Skuadra e Llapit ka bërë transferimin e radhës në këtë afat kalimtar veror. Ahmed Januzi është bashkangjitur me skuadrën në fazën përgatitore në Banjë dhe në këtë edicion do t'i mbrojë ngjyrat e Llapit. Januzi vjen si një përforsim i madh për sulmin e skuadrës, duke ditur karrierën e tij vendore dhe ndërkom-bëtare.

Rooney: Unitedi e ka të vështirë ta fitojë titullin

Golashënuesi më i mirë i të gjitha kohëve në Manchester United, Wayne Rooney, shpreson se ish-klubi i tij do ta fitojë titullin e Premierë Ligës, por thotë se "Djajve të kuq" iu nevojiten edhe dy lojtarë të ri për ta bërë këtë gjë. "Mendoj se do të jetë e vështirë pas sezonit që patën vitin e kaluar. Manchester City është duke luajtur futboll të mrekullueshëm, por unë shpresoj se dikush do t'i mposhtë, do të ishte mirë, kështu që shpresoj që ai klub të jetë Manchester Unitedi. Mendoj se i nevojiten edhe një ose dy transferime. Ata kanë ndeshjen kundër Leicesterit të premtën, kështu që shpresoj se ata do të shkojnë një hap më tutje këtë sezon dhe ta kthejnë trofeun përsëri në 'Old Trafford'", ka deklaruar Rooney.

Kovaqi: Bayerni nuk e transferon Rebiqin

Bayern Munchen ka përjashtuar mundësinë e transferimit të yllit kroat Ante Rebiq nga Eintracht Frankfurt. 24-vjeçari që shkëlqeu në Kupën e Botës me Kroacinë ka qenë edhe shënjestër e Manchester Unitedit. "Nuk ka asgjë mes Bayernit dhe Ante Rebiqit. Ai është një personalitet i fortë dhe një lojtar i madh, por nuk do të transferohet te Bayerni", ka thënë trajneri Kovaq.

Humbet jetën kampioni i botës në Atletikë

Atleti kenian Nicholas Bett, i cili u shpall kampion botëror në garën e 400 metrave në "Pekin 2015", ka ndërruar jetë në një aksident rrugor në vendin e tij. Sipas raportimeve, ai ishte kthyer nga kampionati kontinental që po zhvillohej në Nigeri. 28-vjeçari humbi kontrollin e makinës duke rënë në një kanal, e konfirmuar zyrtarisht nga familja e sportistit dhe policia keniane. Bett bëri histori në Botërorin e vitit 2015 në Pekin, duke u bërë keniani i parë që fitonte një titull ndërkombëtar për distanca më të shkurtra se 800 metra. Ai në të kaluarën ka fituar edhe medalje në kampionatet afrikane. Federata Ndërkombëtare e Atletikës deklaroi se ky është një lajm mjaft i trishtë për të gjithë botën e sportit. Në mesazhin ngushëllues, IAAF kujton se Bett ishte një nga surprizat më të mëdha në vitin 2015, ku fitoi medaljen e arit në Botëror me kohën 47 sekonda e 79 të qindtat.

Dembele larg Barçës, afër Arsenalit

Ousmane Dembele pritet të jetë përforsim i fundit i Arsenalit për edicionin e ri, kanë njoftuar mediumet angleze. Bëhet me dije se Arsenali ka kohë që ka nisur negociatat për Dembelen, për të cilin Barcelona po kërkon 100 milionë euro. 21-vjeçari nuk bën pjesë në planet e trajnerit të Barçës, Ernesto Valverde, edhe pse u transferua verën e shkuar me bujë të madhe nga Dortmundi për 105 milionë euro. Dembele është pajtuar me kontratë pesëvjeçare tek Arsenalit dhe deri të enjten kur edhe përfundon afati kalimtar në Premierë Ligë, ai pritet të zyrtarizohet te skuadra londineze.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Adresa:Rr .Isa Boletini pn. tel.: +381 (0)280 23 603 .e-mail :
dshcs@gjilani-komuna.org



Nr: _____
Datë: _____ 2018
G j i l a n

Në bazë të nenit: 7, 8, 10 paragrafi 1, nënparagrafi 2.1, dhe 2.2 nenit: 15, paragrafi:1,2 dhe 3 të Ligjit të Punës nr: 03/L-212, nenit 5 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, dhe U.A. nr: 7/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale publikon:

K O N K U R S

I.- Titulli: /3/ tre doktorë të mjekësisë, një/1/ në kohë të caktuar gjër në kthimin e punëtorit Mbikqyrës: Drejtori i QKMF^{sc}

Kushtet:

- Përgaditja superiore/ Fakulteti i Mjekësisë- drejtimi i përgjithshëm/
- Të jetë i licencuar
- Të njohë punën me kompjuter

Kontrata e punës: / dy/ në kohë të pa caktuar /një/ në kohë të caktuar.

Koeficienti: 7.20

Orari i plotë i punës: 40 orë në javë

Puna provuese: /6/ gjashtë muaj.

Përshkrimi i shkurtër i punëve: Ofron shërbime shëndetësore nga kujdesi primar shëndetësor , kontrollon pacientët, cakton diagnozat, ndërmer veprimet e mjekimit të pacientëve, propozon hulumtime dhe masa për trajtimin e sëmundjes, konsultohet me kolegët, punon në QMF në shërbimet përkatëse të mjekësisë familjare, bën implementimin e programit të Mjekësisë Familjare, jep këshilla dhe udhëzime pacientëve sugjeron propozon dhe përshkruan terapinë e nevojshme, për punën e vet i jep llogari shefit të shërbimit dhe Drejtorit të QKMF^{sc}.

II.- Titulli: /2/ dy teknik laborant

- a). 1/një/ me pregaditje të lartë profesionale /baqellor/
- b). 1/një/ me pregaditje të mesme

Mbikqyrës, shefi dhe drejtori

Kushtet:

- Nën: a- Pregaditja e lartë profesionale /baqellor/ -drejtimi laborant i biokimisë
- b- Përgaditja ; shkolla e mesme e mjekësisë drejtimi – teknik laborant
- Të jetë i/e licencuar

Kontrata e punës : në kohë të pacaktuar

Koeficienti: 5.40

Orari i punës: 40 orë në javë

Puna provuese: /6/ gjashtë muaj.

Përshkrimi i shkurtër i punëve: Pranon udhëzimet nga mjeku për analiza laboratorike kujdeset që analizat të jenë të karta dhe reale,kujdeset për mirëmbajtjen e aparaturës për analiza,mban llogari për të gjitha smundjet infektive dhe raporton në organet përkatëse, kujdeset për apote të mira mes pacientvedhe punëtorëve shëndetësor , kujdeset që rezultatet e analizave të kryhen dhe të ju dorëzohen pacientve në kohën e duhur,bashkëpunon ngusht me kolegë dhe i kryen në mënyrë profesionale detyrat e parashtruara nga shefi.

III.- Titulli: /5/ pesë infermier/e

Mbikqyrës, shefi dhe drejtori

Kushtet:

- Shkolla e mesme e mjekësisë
- Të jetë i/e licencuar

Kontrata e punës : në kohë të pacaktuar

Koeficienti: 4.80

Orari i punës: 40 orë në javë

Puna provues: 6 /gjashtë/ muaj

Përshkrimi i shkurtër i punëve: jep informata pacienteve lidhur me kujdesin i cili ofrohet në institucionin shëndetësor, administron dhe mban llogari për terapinë e përshkruar nga doktori , ndërmer masa për parandalimin e infeksioneve, kontribon rreth mbajtje së higjenes , mirëmban në mënyrë të duhur të gjitha pajisjet e nevojshme për punë, merr pjesë në trajnime të organizuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive shëndetësore në mjekësinë familjare, kontribon në krijimin e raporteve të shëndoshta mes pacientit dhe personelit , kryen edhe punë të tjera sipas urdhërit të personit përgjegjës.

IV.- Titulli: /1/ një teknik/e, të stomatologjisë

Mbikqyrës: shefi i shërbimit të stomatologjisë

Kushtet:

- Shkolla e mesme e mjekësis / drejtimi teknik i stomatologjisë/
- Të jetë i/e licencuar

Kontrata e punës: në kohë të pa caktuar

Koeficienti: 4.80

Orari i punës:40 orë në javë

Puna provuese: 6 /gjashtë/

Përshkrimi i shkurtër i punëve: Administron dhe mban llogari për të gjitha instrumentet e punës në ordinancën e stomatologut, ndërmer masa për parandalimin e infeksioneve, angazhohet në mbajtjen e higjenes.mirëmban në mënyrë të duhur të gjitha pajisjet për punë në shërbimin stomatologjik, merr pjesë në trajnime të ndryshme të cilat parashihen për ngritje të vazhdueshme profesionale nga lëmi i stomatologjisë, angazhohet për raporte të mira me pacient dhe kolegë, si dhe kryen punë tjera të parashtruara nga kryeinfermierja, shefi apo eprori.

Çdo aplikues për pozitën e lartcekura duhet të plotësoi dhe dorëzoj dokumentacionin me sa vijon:

- Fletë aplikacionin e plotësuar
- Dokumentacionin mbi përgatitjen dhe kualifikimin profesional/ fotokopje/
- Licencën e punës
- Dëshmin nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime (e vlefshme brenda afatit gjashtë mujor)
- Çertifikatën mbi gjendjen shëndetësore (e vlefshme brenda afatit gjashtë mujor)

Kandidatët të cilët aplikojnë për dy apo më shumë pozita të shpallura janë të obliguar që për çdo pozitë të plotësojnë nga një aplikacion dhe të cekin se për cilën pozitë aplikojnë.

Të gjithë kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë , do të ftohen në intervistë dhe për datën dhe vendin e mbajtjes së intervistës do të njoftohen me kohë.

Aplikacionet merren dhe të plotësuar dorëzohen në Arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, gjegjësisht në zyrën për marrëdhënie me publikun-shërbimi me qytetarë.

Afati për aplikim është /15/ pesëmbëdhjetë ditë, nga dita e shpalljes publike në gazetë ditore, dhe mjete tjera të informimit, Dokumentet e pa kompletuara dhe ato të cilat arrijnë pas afatit nuk do të shqyrtohen.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Adresa:Rr .Isa Boletini pn. tel.: +381 (0)280 23 603 .e-mail :
dshcs@gjilani-komuna.org



Br: _____
Datum: _____ 2018
Gnjilane

Na osnovu clana 7, 8, 10 stav 1, podstav 2.1, i 2.2 clana: 15, stav: 1,2 i 3 /akona o radu broj: 03/L-212, clana 5 Kolektivnog Sektorskog Zdravstvenog Ugovora, i A.U. br: 7/2017 za regulisanje procedura za uspostavljanje radnog odnosa u javnom sektoru, Uprava za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje objavljuje:

KONKURS

I. Naziv:/3/ tri doktora medicine, jedan /1/ na odredjeno vreme do povratka radnika Nadzorni: Direktor GCPM

Uslovi:

- Superiorna priprema/Medicinski fakultet-opsti smer/
- Da bude licenciran
- Da poznaje rad na kompjuteru

Radni ugovor:/dva/ na neodredjeno vreme /jedan/ na odredjeno vreme.

Koeficient:7.20

Puno radno vreme:40 sati sedmicno

Probni rad:/6/ sest meseci

Kratak opis poslova: Pruza medicinske usluge pocevsi od primarne zdravstvene nege, kontrolise pacijente, odredjuje dijagnoze, poduzima akcije za lecenje pacijenata, predlaze istrazivanja i mere za lecenje bolesti, vrsi implementaciju programa porodice medicine, pruza savete i uputstva, pacijentima preporucuje i izdaje neophodne terapije, za svoj posao izvestava sefa usluga i direktora GCPM.

II.Naziv:/2/ dva laboratorijska tehnicara

- a) 1/jedan/ sa visokim strucnim usavravanjem/ bachelor/
- b) 1/jedan/ sa srednjom pripremom

Nadzorni: sef i direktor

Uslovi:

- a)Visoka profesionalna kvalifikacija/bachelor/- smer laborant i bio hemije
- b)Priprema, srednja medicinska skola, smer- laboratorijski tehnicar

-Da bude licenciran/a

Radni ugovor: na neodredjeno vreme

Koeficient:5.40

Radno vreme:40 sati sedmicno

Probni rad:/6/ sest meseci

Kratak opis poslova: Vrsi prijem uputnica od strane doktora za laboratorijske analize, vodi racuna da analizc budu jasne i realne, odrzava aparate za analize, odrzava cvidenciju o svim zaraznim bolestima i izvestava relevantne organe, brine o dobrom odnosu izmedju pacijenata i zdravstvenih radnika, vodi racuna da rezultati analiza budu završeni te predati pacijentima na vreme, usko suradjuje sa kolegama i na profesionalan nacin izvrsava duznosti date od strane sefa.

III.Naziv:/5/ pet medicinskih sestara/tehnicara

Nadzorni:sef i direktor

Uslovi:

-srednja medicinska skola

-da bude licenciran

Radni ugovor: na neodredjeno vreme

Koeficient:4.80

Radno vreme:40 sati sedmicno

Probni rad:/6/ sest/ meseci

